

STUDIME DHE ARTIKUJ

Ragip Halili

SANKSIONET PENALE SIPAS TË DREJTËS ZAKONORE TË SHQIPTARËVE NË KOSOVË (II)*

4. Dënimet pronësore

Dënimet pronësore u zhvilluan nga kompozicioni, ndërsa u zhdukën në kohën kur gjakmarrja erdh duke u zëvendësuar gradualisht me dhënien, respektivisht me pagimin e kompenzimit madje nën ndikimin e forcimit të organizatës shtetërore, ndërsa në disa vende dhe te disa popuj edhe nën ndikimin e këmbimit gjithnjë e më të madh të mallrave.

Dënimet pronësore gjithmonë u janë përgjegjur interesave të shtetit dhe të krerëve të fiseve, sepse një pjesë e këtij kompenzimi shkonte në dobi të shtetit, respektivisht në dobi të bajraktarëve të fiseve. Një pjesë e kompenzimit u takonte ndërmjetësve, qoftë pleqve ose bajraktarëve të fiseve, e më vonë edhe shtetit, ndërsa pjesa tjetër i takonte të dëmtuarit. Me qëllim që të fitohet një pasqyrë e qartë për dënimet pronësore në të drejtën zakonore të Kosovës, këtu mendojmë të paraqesim disa dënime pronësore themelore, të cilat zbatohen më së shpeshti ose që zbatoheshin deri vonë.

a) Kompozicioni, respektivisht pajtimi me shpërblim

Gjakmarrja nuk ishte gjithmonë në pajtim me interesat e bashkësive të caktuara, posaçërisht atëherë kur marrëdhëniet shoqërore u bënë më të shumëllojshme dhe më të ndërlikuara.⁵⁸

Që nga kohët e lashta njerëzit përpiqeshin që të ndërpresin gjendjen e turbullirave e të luftës e kjo për arsye se vrasjet për hakmarrje shkaktonin reduktimin e madh të forcave nga të dy palët dhe shkaktonin një jetë të padurueshme te disa bashkësi. Në këto rretha-

* Në pjesën I të këtij punimi, botuar në Nr III/1973, në mes të faqes 32, para pasusit „Bojkoti ose si thuhet në popull leçitja...“ është harruar gabimisht nëntitulli: „3 Bojkoti-leçitja“.

⁵⁸ Dr Tom a Živanović: *Osnovi krivičnog prava - opšti deo*, Beograd, 1922. f. 23-24
M. D. Sargorodskii: *Nakazaniye po ugovnomu pravu eksploatorskoga opšchestva*, Moskva, 1957 fq. 25-26.

na, qetësia shoqërore ndodhej në rrezik të përhershëm, ndërsa siguria personale ishte rrezikuar plotësisht. Kështu, si zhvillimi i shoqërisë, ashtu edhe zhvillimi i individëve në këso situatash konfliktore jo vetëm që vështirësohej, por shpeshherë ishte edhe absolutisht i pamundur. Pasi gjakmarrja përjashtonte mundësitë e çdo lidhje të ngushtë dhe kontakti midis anëtarëve të bashkësive të ndryshme të gjakut, shpejt ranë në sy edhe pasojat e saj të dëmshme për bashkësinë e njerëzve dhe për përparimin në përgjithësi. Prandaj, interesi jetësor i bashkësisë dhe i individëve i shtynte që të heqin dorë nga praktika e gjakmarrjes dhe të gjejnë ndonjë mënyrë tjetër, më të mirë dhe sa të jetë e mundur më pak shkatërruese së zbutjes së konflikteve dhe dënimit në përgjithësi, me të cilën nuk do të dobësohej në një masë aq të gjerë forca shoqërore, kohezioni i bashkësisë dhe përmes së cilës do të mprohej e drejta me sa më pak viktima dhe pasoja sa më të lehta si për bashkësinë, ashtu edhe për individët.⁵⁹

Me zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike, midis grupeve të caktuara shoqërore vendosen kontakte të ndryshme. Anëtarët e këtyre grupeve shkojnë sa të jetë e mundur më shumë në drejtim të ndihmës dhe të mirëkuptimit reciprok. Për shkak të kësaj situatë dhe arsyeve të tjera, gjakmarrjen e zëvendëson kompozicioni, respektivisht pajtimi, krahas me pagimin e një kompenzimi të caktuar. Ky kompenzim në fillim konsistonte në një numër të caktuar bagë-tish, respektivisht tufash, e më vonë edhe në shuma të caktuara të hollash. Sipas mendimit të shumicës së autorëve, s'mund të caktohet me saktësi kufiri i mbarimit të institucionit të gjakmarrjes dhe i fillimit të pajtimit me shpërblim, respektivisht të kompozicionit.⁶⁰

Natyrisht, ky proces u zhvillua gradualisht dhe në mënyrë të ndryshme në viset e ndryshme të botës. Mbisundon mendimi se institucioni i kompozicionit u shfaq në periodën kalimtare, në periodën e shkatërrimit të bashkësive primitive dhe të krijimit të shtetit. Mirëpo, kjo sdo të thotë se ata kanë të drejtë, sepse kemi edhe periudha kur gjakmarrja koekziston për një kohë me sistemin e kompozicionit e, për më tepër, me disa dënime pronësore të legjislaturës bashkëkohore. Ne nuk duhet të shkojmë fort në të kaluarën për t'u njohur me këtë, sepse këtë situatë, në një trajtë mjaft origjinale, e ndeshin sot në Kosovë dhe në disa vise të tjera të vendit tonë, ku gjakmarrja dhe pajtimi me shpërblim janë të pranishme në praktikën e zgjidhjes së konflikteve reciproke.⁶¹

⁵⁹ M. Kovalevski; *Savremeni običaji i drevnji zakoni*, vëllimi i dytë, Moskë, 1886, f. 55-56. Dr. Rajka Mladjenović, Kupčević: *Osnovi penologije*, Sarajevë 1972, f. 54-55

⁶⁰ Për shkak të kësaj, nën ndikimin e jetës së zhvilluar ekonomike, u shfaqë një formë e re e reagimit kundër krimeve të kryera, e cila në shkencë është e njohur me emrin kompozicion, e cila fjalë rrjedh nga termi latin *componere*, që do të thotë bashkim respektivisht pajtim me shpërblim. Prandaj pajtimi me shpërblim ose kompozicioni e ka zanafillën e vet qysh në kohën kur bashkësitë e gjakut me vend të përhershëm banimi filluan të shkapërderdhën në bashkësi të karakterit ekonomik, ndërsa individët filluan të formojnë lidhje jo në bazë të lidhjes së gjakut por në baza të intereseve të përbashkëta materiale. (dr Ilija Jelčić: *Krvna osveta i umir u Crnoj Gori i Severnoj Arbaniji*, Beograd 1926 f. 11-12).

⁶¹ Institucioni i pajtimit me shpërblim është shumë i rëndësishëm edhe në të drejtën zakonore të Kosovës. Kështu, ky zbatohet rregullisht në rastin e zgjidhjes së konflikteve rreth gjakmarrjes.

Prej të gjitha formave të reagimit shoqëror kundër sjelljeve të palejueshme të individëve e të grupeve, kjo formë është ruajtur më së shumti. Shteti, duke dashur që ta çrrënjosë reagimin privat dhe autokracinë e individëve e të grupeve, ka favorizuar veçanërisht kompozicionin të të gjitha ato vepra penale e delikte që nuk i përka-sin jurisdiksionit të tij. Kjo formë e rregullimit të konflikteve është e përshtatshme për shtetin, posaçërisht për shkak se ai merr për ve-te një pjesë të kompenzimit. Me rastin e çdo pajtimi, shteti, përmes organeve të tij të posaçme, merr pjesë si në caktimin e lartësisë së shpërblimit ashtu edhe në ndarjen e kompenzimit. Prandaj, ai insiston që pajtimi të jetë i obligueshëm për të gjitha palët dhe për të gjitha konfliktet. Kemi plot raste në të cilat shteti me përdhu-në i pajton palët që janë në konflikt dhe, kuptohet, e ndan për vete një shumë të caktuar të hollash. Në këtë mënyrë, për veprat të ca-ktuara penale, ai parasheh edhe lartësinë e caktuar të kompenzimit.⁶²

Esenca e kompozicionit — pajtimit me shpërblim qëndron në fa-ktin që kryerësi i veprës penale ose të afërmit e tij të gjakut, i pagu-ajnë të dëmtuarit ose familjes së tij një shumë të caktuar të kompe-nzimit, e më vonë një pjesë edhe gjyqit të pleqve, respektivisht shte-tit. Lartësia e shpërblimit dhe mënyra e pagesës caktohen përmes zakoneve të vendit, marrëveshjes ose nxirren me zbatimin e kërcë-nimit ose të forcës nga ana e të dëmtuarve, respektivisht shtetit. Pa marrë parasysh këtë, mund të themi se burimi i pajtimit, respekti-visht i kompozicionit qëndron në bindjen ose në vetëdijën e anëtarëve të një bashkësie të caktuar se disa konflikte dhe mospajtime duhen zgjidhur me anë të marrëveshjes ose faljes. Për këtë shkak, në lite-raturë thuhet shpesh se kompozicioni, respektivisht pajtimi shfaqet më tepër si manifestim i të gjykuarit me pjekuri se sa si jehonë me karakter shqisor ose instiktiv të njeriut, siç është rasti të gjakma-rrja. Në Kosovë dhe në disa vise të tjera të vendit tonë edhe sot e kësaj dite janë ruajtur mirë zakonet dhe rregullat e pajtimit me shpërblim e deri vonë këtë institucion e njihnin edhe malazezët.⁶³

Qysh më parë në këto vise ekzistonin disa rregulla të pashkru-ara lidhur me mënyrën e pajtimit. Vetë akti i pajtimit të palëve të ngatërruara përcillej me një ceremoni të posaçme, gjë që në një më-nyrë dëshmonte seriozitetin dhe rëndësinë e këtyre institucioneve. Sipas të drejtës zakonore në Kosovë, madje edhe më parë, ekzistonin disa mënyra pajtimesh si: pajtimi i obligueshëm dhe pajtimi fakul-tativ. Sot në praktikën e përditshme më tepër zbatohet pajtimi fakul-

⁶² Kështu ka qenë gjatë sundimit turk dhe paraluftës, kur organet e pushtetit mbanin për vete një shumë të caktuar të hollash. Këtë çështje e rregullon deri diku në mënyrë të ngjajshme edhe Kanuni i Lekë Dukagjinit (KLD), sipas dispozitave të të cilit një pjesë e të hollave të gjakut u mbetet krerëve dhe pleqve. Kështu psh. T. Zivanović thekson: „Por, kur më vonë pushteti filloi të dominojë mbi fiset, ai jo vetëm që imponoi kompozicionet, por edhe caktoi lartësinë e tij dhe njëherit kujdeset për pagimin e tij. Shumën e shpërblimit për të lënduarin kryerësi ishte i detyruar ta paguajë sipas normave të parapara nga ana e pushte-tit. (T. Zivanović, *vepra e cit.* f. 24).

⁶³ K. Jeriček dhe J. Radonjić: *Istoriya srba - kulturna istorija*, Beograd, 1952 f. 135—137.

tativ. Kjo për arsye se organet shtetërore pas çlirimit e deri më sot nuk i detyruan personat e ngatërruar dhe ata që janë në gjak të pajtohen, duke iu kërcnuar me një dënim të caktuar, siç ndodhte dikur.⁶⁴

Tek ne këtë jemi përpjekur ta kompenzojmë përmes punës së këshillave të pajtimit, institucion ky që është shumë i ngjashëm me institucionin e gjyqit të pleqve e që punon në kuadër të organizatës së LSPPJ pranë meseve të caktuara të fshatrave e të qyteteve dhe i cili ndonjëherë arrin t'i pajtojë palët që janë në konflikt, jo duke i detyruar, por duke i bindur e duke arritur marrëveshje.⁶⁵

Mirëpo, në popull, siç thamë, jashtë këshillave të pajtimit ekziston gjyqi tradicional i pleqve, i cili cakton pajtimin dhe kushtet e shpërbljes. Ky gjyq quhet Pleqtë e gjakut. Një gjyq i këtillë ka ekzistuar qysh më parë jo vetëm në Kosovë, por edhe në Mal të Zi dhe në Shqipërinë veriore. Ai përbëhej zakonisht nga përfaqësuesit e të dy palëve që ishin në konflikt dhe nga burrat e tjerë të njohur të rrethit, të cilët dalloheshin si njohës të mirë të dokeve e të zakoneve të atij vendi. Këta burra shpesh shfaqen si ndërmjetës, respektivisht si pajtues, që luajnë një rol të madh e human, poqese përpiqen me mish e shpirt për zgjidhjen e drejtë të çështjes. Numri i anëtarëve të këtyre gjyqeve nuk është i caktuar dhe varet prej rastit konkret. Kur ishte fjala për pajtimin e familjeve të mëdha e të njohura, atëherë, natyrisht, numri ishte më i madh dhe për anëtarë të gjyqit zgjedheshin ata që ishin më autoritativë dhe më të njohur, e poqese ishte fjala për pajtimin e familjeve më të vogla e të varfëra, atëherë gjyqi përbëhej zakonisht nga burra me reputacion më të vogël e më pak të njohur.⁶⁶

Ky gjykim dhe kjo procedurë e pajtimit shpeshherë zgjateshin shumë e ishin të vështirë. Sipas mendimit të përgjithshëm që dominon, jeta e njeriut është e paçmueshme dhe e pazëvendësueshme, anëtar i humbur i familjes dhe i vëllazërisë s'mund të paguhet me të holla, dhembja, pikëllimi, turpi dhe nderi i cënuar i më të afërmit nuk mund të kompenzohen me ndonjë shpërblim material, por sidoqoftë, në disa raste duhet lëshuar pe. Në këtë mënyrë, që nga kohët më të lashta u gjetën disa burra — pleq, të cilët me urtinë e këshillave të veta dhe me autoritetin e tyre moral dalngadalë arritën që t'i imponojnë rregullat për zbutjen e konflikteve mes familjeve, për evitimin e disa dukurive negative etj. Ata përdornin herë bindjen e herë forcën, ishin të detyruar të orientohen sipas rasteve, të veprojnë me kujdes e gradualisht, të presin momentin e volitshëm që të mund të vazhdojnë punën e rëndë rreth pajtimit. Në fillim metoda dhe mënyra e punës së tyre ishte kryesisht që të përcaktojnë një praktikë të caktuar, t'i paraqesin disa raste si presedanë, t'i shndë-

⁶⁴ Ramadan Vraniqi — dr Syrja Pupovci: *Këshillat e Pajtimit në Kosovë e Metohi*, Përparimi nr. 5, 1968 f. 541 — 542, 546 — 548, 558 — 559.

⁶⁵ Ragip Halili: *Pleçnija u Zakoniku Leke Dukađinija*, Anali Pravnog fakulteta u Beogradu, nr. 5, 1970, f. 534—536, 542, 543.

⁶⁶ I. Jelić: *Vepra e cit.* f. 103—104.

rrojnë në zakon të gjitha ato që i kontribuonin sendërtimit dhe kryerjes së „misionit dhe të detyrës së tyre pacifiste” dhe që në këtë mënyrë të krijonin tradita të reja.⁶⁷

Kompenzimi material që i caktohej familjes së të vrarit quhej „paret e gjakut”. Ai më parë dhe sot jepet më shumë si një pranim i fajit, respektivisht i gabimit dhe si shenjë kujdesi e dhembshurie të thellë nga ana e familjes së vrasësit, se sa si një lloj çmimi i gjakut të të vrarit. Prandaj, në këto vise ngjante shpesh që familja e të vrarit të mos pranojë kurrfarë kompenzimi material për anëtarin e vet të vrarë, por zakonisht pranonte ndonjë gjë që në një mënyrë simbolike në këto anë paraqet satisfaksionin moral e material. Këto gjëra zakonisht ishin pushka, kutia e duhanit, ora e xhepit, kali i shalës etj. Këto gjëra, sipas të drejtës zakonore, paraqisnin edhe vlerat më të mëdha dhe bindjen se ana kundërshtarë ishte e vetëdijshme për fajin e vet, e kjo ishte njëkohësisht edhe një lloj dënimi dhe përrulje për ato familje, sepse kishin ardhur në një situatë të atillë që duhej t’i jepnin gjërat e përmendura, të cilat trimi i mirë nuk i fal dot.⁶⁸

I dënuari ishte i detyruar që ta paguajë shpërblimin e gjakut sipas shumës dhe afatit të caktuar. Të gjithë anëtarët e vëllazërisë kishin për detyrë që, në qoftë se i dënuari, respektivisht familja e tij nuk ishin në gjendje të paguajnë kompenzimin, t’u ndihmonin dhe të flijoheshin jo vetëm materialisht, por edhe moralisht. Kjo për arsye se fundi i fundit pajtimi kishte rëndësi për tërë vëllazërinë, sepse po të mos bëhej pajtimi, gjakmarrjes do t’i nënshtrohej e tërë vëllazëria. Prandaj, në këto rrethana, të gjithë ishin të obliguar të kontribuonin aq sa mundnin, në mënyrë që shpërblimi i gjakut, të paguhej me kohë. Në rast se kishte të vrarë e të plagosur të dy palët, atëherë së pari bëhej anulimi i plagës për plagë, dy plagëve për një vrasje (kokë), i kokës për kokë etj. Kur të zgjidhej kjo çështje, atëherë bëhej caktimi i lartësisë së shpërblimit të gjakut, e cila në vise të ndryshme caktohej ndryshe. Mirëpo, që më parë ekzistojnë disa rregulla të caktuara, disa shuma të fiksuara të hollash ose disa vlera të caktuara, qoftë në bagëti, qoftë në gjësende, të cilat ndryshojnë prej një krahine në tjetrën.⁶⁹ Mund të themi se gati në të gjitha viset për vrasjen ekziston një çmim, respektivisht një vlerë unike.

Pos shumës së përmendur të të hollave, respektivisht vlerës së caktuar, familja e vrasësit, sipas rregullave zakonore, ka për detyrë që të shtrojë edhe të ashtuquajturën „darkën e gjakut”, respekti-

⁶⁷ Po aty.

⁶⁸ Me anë të marrjes së armëve dhe kalit të kryerësit dhe me përdorimin e tyre nga ana e palës së dëmtuar, arriheshin dy efekte: nga njëra anë kënaqej ndjenja e drejtësisë tek të dëmtuarit, kurse, nga ana tjetër, ky ishte një denim nijaft i rreptë për kryerësit, sepse atij deri diku i ulej krenaria dhe nderi, sepse, në këto vise, ku trimëria dhe bujaria çmohen si vertyte të larta, mendohet se nuk ka turpë më të madh për trimin e vertetë se sa kur për së gjalli tjetri ja mban armët dhe i hyp kalit të tij, pa marrë parasysh se si është arrijtur kjo (I. Jelić, *vep. e cit.* f. 86—87).

⁶⁹ Andrija Jovičević: *Malësia*, Srpski etnografski Zbornik, libri 15, viti 1923, Beograd, f. 97—98, 105 — 108 etj.

visht „drekën e gjakut”, ku fton tërë vëllazërinë, familjen dhe vëllazërinë e të vrarit, gjyqtarët e gjyqit të pleqve dhe njerëzit e tjerë të njohur si dhe ndërmjetësit. Kjo darkë, respektivisht drekë, duhet të jetë e begatshme dhe në nivelin e duhur. Këtu duhet të shihet dhe ndihet se i zoti i shtëpisë ka bërë çmos dhe s’ka kursyer asgjë për këtë çast solemn e të rëndësishëm.

Përpara ishte zakon, ndërsa sot kjo gjë varet nga vetë vullneti i familjeve të pajtuara, që pos pajtimit të probatinohe, respektivisht të bëhen kumbarë ose të miqësohen në mes vedi. Ky akt e kishte edhe domethënien e vet, sepse vëllamëria ose kumbaria shënonte garancinë se e kaluara është harruar dhe se po fillonin marrëdhënie të reja, të cilat kishin atë karakter që i detyronin t’i përmbaheshin marrëveshjes së paqes. Jemi të mendimit se një praktikë e këtillë ndikoi shumë që këto marrëveshje të respektohen përgjithmonë. Përkundrazi, sot kur këto forma të afrimit lidhen më rrallë, rastet e gjakmarrjes janë të shpeshta edhe pas pajtimit dhe shkeljeve të tjera të marrëveshjes së gjobës. Mirëpo, me qëllim që të evitohen shkeljet eventuale të marrëveshjeve të këtilla, si e drejta zakonore, ashtu edhe praktika e sotme, parashohin që në këto raste të caktohen edhe dorëzanët, qoftë nga pala e të dëmtuarit, qoftë nga pala tjetër, e shpeshherë si dorëzanë bëhen edhe persona të tretë, të pa interesuar për konfliktin. Ata, me nderin e tyre garantojnë që, në rast se ndonjë nga palët do të shkelë marrëveshjen për gjobën, vetë do të intervenojnë dhe, duke përdorur forcën, do t’i detyrojnë palët t’i përmbahen marrëveshjes, e ndonjëherë edhe vetë do të ndër marrin sanksione të rrepta kundër shkelësve të marrëveshjes. Për dorëzanë zakonisht merren ata individë ose burra të njohur, të cilët rrjedhin nga familjet në zë, ata që gëzojnë respekt të posaçëm dhe që disponojnë njëfarë force, të cilën do ta përdornin në rast nevojë ose nga vetë fakti që rrjedhin prej familjeve të këtilla, t’u fusin frikën palëve në marrëveshje qoftë me forcën e autoritetit, qoftë me forcën e pushtetit të tyre. Zakonisht, dorëzanët rrjedhin nga familjet me shumë meshkuj, familje këto që në çdo moment janë në gjendje të ndër marrin sanksione të rrepta dhe të hakmerren për nderin e cënuar të anëtarit të tyre që është dorëzanë.⁷⁰

b) Dënimet në të holla

Sikurse edhe dënimet e tjera pronësore, edhe dënimi në të holla u krijua nga kompozicioni. Mirëpo, ai s’ka qenë i njohur në të drejtën zakonore në trajtën e tij të sotme e madje as sot nuk e ka

⁷⁰ „Poqese pas pajtimit shkaktohet ndonjë marrëveshje në mes të familjeve të pajtuara, dorëzanët janë të detyruar të ndërmjetësojnë në mënyrë që të mos turpërohet emri dhe dorëzania e tyre (§ 939 KLD) ose...” Poqese ngjan vrasja në mes të këtyre dy familjeve, dorëzanët duhet të hakmerren kunder atij që e ka shkelur pajtimin.... (§ 686 KLD), dorëzani nuk merr pjesë në këtë punë që të mbajë në mend por që të sigurojë zbatimin e saj në jetë (§ 940 KLD). Mu për këtë, si më parë, ashtu edhe sot si dorëzanë merren ata burra, të cilët janë në gjendje që përveç me autoritetin e tyre të ndër marrin edhe masa tjera të shtërngimit.

po atë karakter. Dihet se dënimi në të holla, sipas kuptimit të rregullave pozitive, ka të bëjë me obligimin e pagimit të një shume të caktuar të hollash në dobi të arkës shtetërore nga ana e kryerësit të veprës penale dhe zakonisht manifestohet me zvogëlimin e pronës së tij. Në këtë mënyrë, midis kryerësit të veprës penale dhe shtetit krijohet një marrëdhënie obligacioni, ku shteti na paraqitet si kreditor, kurse kryerësi i veprës penale si debitor. Në fillim dënimi në të holla kishte karakter të pastër fiskal, e më vonë ai fillon të marrë gjithnjë e më shumë karakter represiv.⁷¹

Në shkencën e të drejtës penale dhe në penologji është diskutuar një kohë të gjatë lidhur me esencën e dënimit në të holla, për anët e mira e të këqia të tij ose për vendin e tij në sistemin e sanksioneve penale. Në këtë drejtim ekzistojnë disa pikëpamje që, në një anë, pajtohen me këtë dënim e, nga ana tjetër, disa të tjerë e kritikojnë këtë.⁷²

Sipas të drejtës zakonore, dënimi në të holla ka më tepër karakter të kompenzimit të dëmit, se sa karakter fiskal ose represiv, edhe pse nuk mund t'i mohojmë plotësisht as këto karakteristika. Pasi atë zakonisht e shqipton gjyqi i pleqve, d.m.th. një institucion jozyrtar e joshtetëror me karakter zakonor, kuptohet se ai nuk ka karakter juridik-zyrtar, por ka karakter juridik-privat. Sipas dispozitave të KLD, dënimi në të holla ose „gjoba”, siç e quan populli, në disa raste kishte pasur karakter fiskal madje atëherë kur kryerësi i ndonjë veprë penale ishte i dënuar që pos kompenzimit të dëmit të dëmtuarit, t'u paguante në një shumë të caktuar të hollash edhe krerëve, gjyqit të pleqve dhe kishës. Shpeshherë kryerësi i veprës penale, pos kompenzimit të dëmit në po atë shumë ishte i detyruar që këtë kompenzim ta bëjë edhe dyfish, trefish ose katërfish. Nga kjo del se në këto raste dënimi i këtillë në të holla nuk kishte vetëm karakter kompenzimi të dëmit, por edhe karakter represiv. Përmes dënimit në të holla më së shpeshti pengoheshin ato vepra penale që ishin të drejtuara kundër pronës, si psh. të gjitha llojet e vjedhjeve, dëmtimi i gjërave ose pasurisë së huaj e, pos këtyre, përmes dënimit në të holla pengoheshin edhe disa forma të fyerjes, të çpifjes, të lëndimeve të lehta trupore etj. Këtu do t'i paraqesim disa shembuj të shqiptimit dhe të ekzekutimit të dënimit në të holla:

1. Para disa vitesh, në fshatin „L” një fshatari i humbën pa kurrfarë gjurme pesë-gjashtë dhenë. Mirëpo, ai dyshoi se fjala ishte për vjedhje dhe prandaj e fajësoi një njeri nga një vëllazëri tjetër. Pasi i mblodhi disa fakte që vërtetonin supozimin e tij, ai dërgoi disa burra tek ai njeri, tek i cili dyshonte, që t'i bëjnë për dije këtë dhe njëkohësisht t'i thonë që, në qoftë se mendon se është i pafaj-

⁷¹ M. D. Šargorodskii, *vep. e cit.* f. 212—213, 214—215.

⁷² Dr Ljubiša Lazarević: *Kazne i mere bezbednosti u savremenom krivičnom pravu*, Beograd, 1969 f. 73—74; Dr Ljubiša Jovanović: *Krivično pravo — opšti deo*, Beograd, 1969 f. 255.

shëm, atëherë le t'i gjejë dymbëdhjetë pleq, të cilët do të betohen se ai nuk ka vjedhur dhe se në të kundërtën ai do ta parashtronte çështjen para burrave — gjyqit të pleqve. I akuzuari, i zënë ngushtë nga faktet, s'kishte se kah t'ia mbante dhe u pajtua që çështja të shtrohet para gjyqit të pleqve. Pas disa pleqnimesh, gjyqi i pleqve vendosi që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe e dënoi që të paguajë dhentë e vjedhur sipas çmimit të tregut, si dhe 10 000 dinare të vjetër si dënim.

Gjyqi e arsyetoi vendimin e vet, duke thënë se vepra e vjedhjes është e rrezikshme dhe e pandershme për fshatin si dhe e dëmshme për rrethin dhe për marrëdhëniet midis fshatarëve.

Këtu kemi si kompensimin e dëmit, ashtu edhe dënimin, që shfaqet si një lloj represalje ndaj kryerësit.

Në KLD vlen rregulla që në rast vjedhje, kryerësi duhet të paguajë „dy për një”, dmth. për një gjë të vjedhur duhet t'i paguajë dy (&. &. 804-811 KLD).

Në të drejtën zakonore dënimin në të holla e shqipton gjyqi i pleqve i një vendi të caktuar. Gjatë caktimit të dënimit, gjyqtarët u përmbahen shpesh disa rregullave me karakter formal. Në të vërtetë, për vepra të caktuara penale ekziston qysh më parë një shumë e caktuar e dënimit, së cilës duhet t'i përmbahen. Pleqve s'u mbetet asgjë tjetër pos të konstatojnë se kryerësi dënohet për shkak të veprës së caktuar dhe se zbatohet shuma e zakonshme e dënimit në të holla. Mirëpo, në disa raste pleqtë kanë mundur të shqiptojnë dënimin në të holla sipas mundësive dhe pasurisë që e kishte kryerësi i veprës penale dhe, në këtë mënyrë, të caktojnë lartësinë e dënimit, pa marrë parasysh rregullën.

Deri vonë dënimi në të holla paguhej me gjëra të ndryshme, e shumë rrallë me të holla. Kjo është e kuptueshme kur dihet se në këto vise të hollat si mjet këmbimi hynë vonë dhe se për këtë qëllim shërbenin gjëra të tjera, si p.sh. bagëtia, drithi etj. Nga ana tjetër, dimë se e drejta zakonore sot më së shumti zbatohet mu në viset malore e blegtorale, ku këto gjëra edhe sot e kësaj dite luajnë një rol me rëndësi gjatë këmbimit midis banorëve të këtyre viseve. Sidoqoftë, të hollat kanë depërtuar edhe në këto vende, kështu që dënimi në të holla paguhet si në të holla, ashtu edhe me gjërat e përmendura.

Ekzekutimi i dënimit në të holla, në të shumtën e rasteve, kryhet vullnetarisht. Posa gjyqi të marrë vendimin dhe të caktojë shumën në fjalë të të hollave si dënim, i dënuari menjëherë vullnetarisht e plotëson këtë obligim. Poqese i dënuari nuk e bën pagesën e dënimit në të holla në afatin e caktuar, gjyqi i pleqve ia tërheq vërejtjen dhe me këtë rast i cakton një afat të përshtatshëm për plotësimin e obligimit. Në qoftë se as pas kësaj ai nuk e paguan shumën që ia kanë caktuar, gjyqi i fton dorëzanët, të cilët, zakonisht, me rastin e çdo gjykimi duhet të garantojnë kryerjen e pagesës, që ata ta bindin të dënuarin për ta kryer obligimin ose që këtë ta bëjnë ata vetë. Përpara, çdo gjyq i pleqve kishte edhe disa burra të posaçëm për ekzekutimin e dënimit në të holla dhe të dënimeve të tjera pronëso-

re. Ata quheshin gjobëtarë. Në rast se personat e dënuar nuk e plotësonin vullnetarisht obligimin e pagesës së dënimit në të holla, gjobëtarët ishin të autorizuar që me forcë, me përdhunë ta bëjnë pagesën, madje më së shpeshti duke marrë me përdhunë gjërat e caktuara ose bagëtinë. Këtë e parasheh edhe paragrafi 1171 i KLD.⁷³

Sot me rastin e zbatimit të dënimit në të holla hasim në shumë pengesa. Kjo për arsye se ai nuk bëhet vullnetarisht, e as që dorëzanët i kryejnë me rregull obligimet e tyre përse i përket dënimit në të holla, kështu që të dëmtuarit, respektivisht viktimës nuk i mbetet gjë tjetër, pos të sendërtojë të drejtën e vet në mënyrë të pavarur. Kjo marrëdhënie obligacioni shpesh bëhet shkak vrasjesh, lëndimesh të rënda trupore dhe dukurish të tjera negative. Gjyqi i pleqve si institucion i rregullimit fisnor, respektivisht fshatarak, në gjendjen e tanishme s'mund të sigurojë gjithmonë zbatimin në jetë të vendimeve të veta dhe s'mund të ekzekutojë dënimin, sepse nuk ka mundësi t'i detyrojë as individët as familjet, kurse masat e tjera represive sot poashtu nuk mund t'i zbatojë më.

c) Marrja ose shkatërrimi i pasurisë — konfiskimi i pasurisë

E drejta zakonore e Kosovës nuk njeh dënimin klasik të konfiskimit të pasurisë, e as që e quan atë me këtë emër. Shpesh për po atë lloj të dënimit të ngjashëm përdoren terma dhe emra të ndryshëm.⁷⁴ Duhet përmendur poashtu se dënimet pronësore të ngjashme me konfiskimin e pasurisë sot nuk zbatohen në të drejtën zakonore, e kjo ka të bëjë me shkaqet e caktuara që, në radhë të parë, janë rezultat i ndryshimeve të marrëdhënieve shoqërore-ekonomike, e madje edhe të vetë strukturës së familjes patriarkale. Mirëpo, parashtrimi i çështjes së sanksioneve penale nuk do të ishte i plotë, sikur të mos paraqisnim këtu se çfarë kanë qenë ato sipas rregullave të së drejtës zakonore.

Dallimi esencial midis konfiskimit bashkëkohor të pronës dhe atij të së drejtës zakonore qëndron në faktin që konfiskimin nuk e shqipton gjyqi shtetëror dhe prona e konfiskuar nuk i takon shtetit, por këtë dënim e shqipton gjyqi i pleqve dhe kjo bëhet pronë e përbashkët, e shpesh e askujt, respektivisht ngel si pronë e shkretë. Ndonjëherë, ky dënim shfaqet si masë me të cilën shkatërrohet e tërë pasuria e të dënuarit. Për këtë arsye thuhet se ky dënim është njëri nga format arkaike të hakmarrjes, e cila në disa trajta të saj shfaqet aty-këtu edhe sot e kësaj dite. Poashtu ka rëndësi të theksohet se këtë dënim e ekzekutonte një grup i caktuar burrash, respektivisht i tërë

⁷³ A. Jovičević: *vep. e cit.* 97—98.

⁷⁴ Ismet Elezi: *Normat e së drejtës penale zakonore të mbledhura në Kanunin e Lekë Dukagjinit dhe Kanunet, (vendimet e veçanta), referate e kumtesa nr. 1. 1965, Tiranë, f. 24—27; Djordje Milović: Sistem kazni u nekim starim Hrvatskim statutima, Zbornik pravnog fakulteta u Zagrebu, nr. 3—4, 1967, f. 338—339, 341—342.*

fshati ose vëllazëria. Kjo është e kuptueshme, sepse në kushtet e ekzistimit të së drejtës së reagimit privat dhe të zgjidhjes arbitrare të së drejtës dhe solidarësisë së fortë të fafesisit, organi i ndarë s'do të mund të ekzekutonte këtë dënim. Ai godiste shpesh jo vetëm pasurinë e të dënuarit, por edhe pasurinë e tërë ekonomisë së familjes ose të vëllazërisë, gjë që nga ky aspekt mund të konsiderohet tejet johuman. Sipas këtyre rregullave, qëllimi kryesor i këtij dënimi ishte hakmarrja kundër kryerësit dhe familjes së tij. Mirëpo, kuptohet, me rastin e zbatimit të tij, mund të flasim edhe për një lloj preventive të përgjithshme në atë mënyrë që, duke zbatuar dhe duke ekzekutuar këtë dënim, t'u hyjë frika të tjerëve që në të ardhmen të mos bëjnë vepra penale. Siç kemi thënë, në ekzekutimin e këtij dënimi merrnin pjesë më shumë burra e shpeshherë të gjithë burrat e një vëllazërie, respektivisht të një fshati. Kjo mënyrë kolektive e ekzekutimit të dënimit bënte që personi ose familja e dënuar t'i nënshtrohen pa fjalë këtij vendimi dhe të durojnë ekzekutimin e tij. Vetë mënyra e ekzekutimit ishte shumë interesante, gjë që shihet nga paragrafët 1191, 1195, 1197, 1198 e 1199 të KLD.

5. Dënimet e tjera

Përpos dënimeve të përmendura, në popull njihen edhe disa dënime që zbatoheshin dikur, por duhet theksuar se ato s'kanë qenë karakteristike për të drejtën zakonore si të mëparshmit, kështu që edhe janë zbatuar më rrallë. Nga këta më së shpeshti përmenden burgu, dënimet trupore, humbja e nderit, heqja e titullit, vërejta etj.

a) B u r g u — b u r g u s h t ë p i a k

E drejta zakonore e Kosovës nuk e njihte dënimin e marrjes së lirisë, respektivisht burgimin — burgun, e as që e zbaton atë sot gjyqi i pleqve. Ky dënim njihej më shumë tek serbët, madje shumë më heret.⁷⁵

Burgu në të drejtën zakonore të shqiptarëve shfaqet më shumë si masë sigurimi të prezencës së të akuzuarit, se sa si dënim. Në KLD nuk përmendet askund kategorikisht. Mirëpo, në mënyrë indirekte mund të nxjerrim përfundim se kjo masë ekzistonte edhe në të drejtën tonë zakonore. Përmes saj, disa persona mbahen medoemos në shtëpi derisa zgjat shqyrtimi i konfliktit, respektivisht derisa vendos gjyqi i pleqve. Më vonë, nën ndikimin e të drejtës së Sheriatit, shqiptimin e dënimit me burg kanë mundur ta bëjnë edhe gjyqtarët e gjyqit të pleqve, e posaqërisht i ashtuquajturit „Xhibal” komisioni. Mirëpo, me këtë rast s'mund të thuhet se është fjala për një sanksion me karakter të pastër zakonoro-juridik, por ky është një kombinim i së

⁷⁵ Jeriček — Radonjić, *vep. e cit.* f. 130—132.

drejtës otomane të Sheriatit dhe i së drejtës zakonore shqiptare⁷⁶. Në këtë rast, prapa këtij dënimi fshihej pushteti shtetëror, i cili dispononte aparatit e rregullt për detyrimin dhe ekzekutimin e këtij dënimi. Kuptohet, edhe burgun gjegjës. Për këtë arsye ne s'do të ndalemi fort te dënimi me marrjen e lirisë sipas së drejtës së Sheriatit e as në atë se për çfarë veprash penale zbatohet ai, sepse kjo s'ka të bëjë me shqyrtimin tonë, por do të shohim se si dukej ky dënim në të drejtën zakonore dhe a zbatohet apo jo.

Pasi nuk kishte ndonjë organizatë të posaçme shtetërore me pushtet të fortë centralist, por ekzistonte organizata fisnore me një organizim-strukturë të thjeshtë, ku mbretëronte separatizmi fisnor, atëherë kuptohet se s'mund të bëhej fjalë fare për ekzistimin e dënimit të marrjes së lirisë, sepse, siç dihet, për të është i domosdoshëm një pushtet i caktuar me institucione të degëzuara, të cilat do të ekzekutonin këtë dënim. Për këtë arsye, në kuadër të bashkësive fisnore nuk kishte burgje, ato s'mund t'i themelonte e t'i mbante askush. Poashtu në kushtet e ekzistimit të gjakmarjes, gjobës, dëbimit, dënimit në të holla etj., dënimet me burgim ishin të tepërta e madje edhe të panevojshme. Vetë natyra e marrëdhënjeve brenda bashkësive fisnore dhe esenca e reagimit kundër sjelljeve kriminale në ato bashkësi vete në dobi të ekzistimit të panevojshëm të dënimit me marrjen e lirisë. Pasi sipas së drejtës zakonore dënimi ka për qëllim kthimin e të keqes me të keqe, sipas këtyre botëkuptimeve, hakmarrja kundër kryerësit, dënimi me burgim nuk mund t'u përgjigjet këtyre qëllimeve. Kryerësi i veprës penale, po të dënohet me burgim, s'mund të vuajë dhe s'mund të ndiejë po atë dhembje si viktima. Prandaj, kjo masë nuk ka mundur të gjejë zbatim dhe ekzistencë sepse, si e tillë, nuk i përgjigjet qëllimit të reagimit që ishte rrënjësor në vetëdijën e anëtarëve të këtyre bashkësive.

A thua pse dënimi me burgim nuk ekziston në të drejtën zakonore as sot? Mendojmë se nuk ka nevojë të japim kurrfarë shpjegimi kur dijmë se kush dhe në ç'mënyrë mund t'ia marrë lirinë dikujt në kushtet e bashkësisë sonë socialiste.

Për themelimin dhe mbajtjen e burgut duhej të ekzistonte një sistem i zhvilluar i rregullimit shoqëror e juridik, duhej të ekzistojnë organet dhe institucionet përkatëse, ndërsa struktura familjare fisnore ishte e varfër dhe nuk dispononte ndonjë aparat të posaçëm për detyrim. Përpos pleqve dhe krerëve të tjerë të fiseve, për zbatimin e dënimeve të këtilla e të dënimeve të ngjashme me këto, organe të tjera nuk kishte. Nga ana tjetër, këto bashkësi shpesh nuk ishin stabile as në pikëpamje territoriale, kështu që në kushtet e dyndjeve të përhershme, në kushtet e ndërrimit permanent të vendit të banimit e të punës, dënimi me marrjen e lirisë nuk mund të zbatohet. Përkundrazi, në këtë situatë ai vetëm do të ishte i tepërt. Mund të

⁷⁶ Ajo dukej më tepër si një masë preventive me karakter të përkohshëm dhe shërbente si një lloj arrestimi deri sa të mbahej gjykimi nga ana e Xhibalit.

përfundojmë se vetë marrëdhëniet shoqërore-ekonomike e posaçërisht shkalla e zhvillimit të marrëdhënieve juridike, ushtronin ndikimin vendimtar mbi mosekzistimin e dënimit me marrjen e lirisë në të drejtën zakonore të Kosovës. Por, për mungesë të besës pas krimit të vrasjes apo të lëndimit trupor, sot ekziston i ashtuquajti burgu shtëpiak, i cili nuk është dënim i shqiptuar nga dikush, por është një lloj vetëdënimi.

b) Dënimet trupore

Dënimet trupore i njihnin të gjithë popujt e lashtë. Ato ekzistonin në të drejtën zakonore pothuaj tek të gjithë popujt. Këto dënime kanë për qëllim që, duke shkaktuar dhembjen fizike, kryerësve t'u fusin frikën, në mënyrë që të mos e përsërisin më veprën penale, e njëkohësisht kjo do të thotë edhe një lloj hakmarrje. Dënimet trupore ishin shumë të vrazhdëta e johumane.

Sistemi ndëshkimor i të drejtës zakonore të Kosovës nuk njehton ndonjë dënim të posaçëm trupor. Poashtu, këto dënime nuk përmenden as në KLD.⁷⁷ Ndërkaq, në të drejtat e tjera këto dënime ishin dukuri e zakonshme. Sipas të drejtës zakonore të shqiptarëve dhe bindjes së përgjithshme që mbretëron në popull, dënimeve trupore u shtrohen kafshët, e jo njerëzit. Prandaj, kur dikush hante një shuplakë, ofendohej rëndë dhe këtë nuk e harronte kurrë, por gjithsesi përpiqej që të hakmerrej. Për këtë arsye këto dënime s'mund të shqiptoheshin aq shpesh, veçanërisht kundër meshkujve të rritur dhe psiqikisht të shëndoshë. Këto dënime zbatoheshin shpesh kundër femrave, fëmijëve dhe personave psiqikisht të sëmurë.⁷⁸

Në të drejtën zakonore, fëmijët, gjithashtu, gëzonin një tretman të posaçëm, kështu që ata nuk jepnin gjithmonë përgjegjësi penale dhe disa sanksione nuk mund të shqiptoheshin kundër tyre. Për fajet dhe sjelljet e palejueshme të fëmijëve jepnin përgjegjësi prindërit, respektivisht kujdestari i familjes, i cili kishte një pushtet të pakufishëm mbi ta. Ai mund t'i ndëshkonte fëmijët me ndëshkime të ndryshme trupore, e në disa raste edhe mund t'i vraste.⁷⁹

Prandaj, në qoftë se ndonjë i mitur sillej në mënyrë kriminale, i dëmtuari sipas rregullit i drejtohej kujdestarit të familjes, i cili zakonisht kishte përgjegjësi të plotë për fajet e fëmijëve. Në këto raste, kujdestarit të familjes i takonin të gjitha pasojat, duke përfshirë këtu edhe dënimet e ndryshme. Mirëpo, në disa raste, delikuentëve të mitur mund t'u shqiptoheshin disa dënime trupore dhe madje më së

⁷⁷ Në dispozitat e KLD, të cilat kanë të bëjnë me dënimet dhe veprat penale, askund nuk përmenden dënimet trupore. Kjo është në pajtim me parimin, i cili përmendet shpesh se: „njeriu nuk është kafshë, atij ose i duhet tërhequr vërejtjen me fjalë, ose duhet vrarë për veprën e berë”. Përndryshe, çdo dënim trupor në çfarëdo mënyre qoftë konsiderohej si cënim i rëndë i nderit dhe i dinjitetit.

⁷⁸ - ⁷⁹ Dënimet trupore zakonisht i ekzekutonte i zoti i shtëpisë edhe atë në të shumtën e rasteve vetëm kundër anëtarëve të mitur të familjes. (Kjo sipas informatave të mbledhura në teren dhe bisedave me njohësit e të drejtës zakonore).

shpeshti ndëshkimi me rrahje. Me të dënoheshin ata të mitur, që ishin të papërmirsueshëm dhe kundër të cilëve prindët nuk ishin në gjendje të ndërmerrnin masa përkatëse për edukimin dhe përmirësimin e tyre. Zbatimi i dënimit trupor kundër fëmijëve, madje edhe kundër të rriturve, varej në një masë të gjerë edhe nga pozita ekonomike, religjioze e morale si dhe nga vetë prestigji i familjes, së cilës i përkiste delikuenti.

Pasi ndëshkimet trupore, e veçanërisht ndëshkimet me frushkullim, respektivisht me rrahje populli i konsideronte përherë si turpërim dhe përulje, atëherë kuptohet vetvetiu se ky dënim s'mund të zbatohet kundër familjeve të shquara e të pasura si dhe kundër përfaqësuesve të të ashtuquajturave familje të forta — familje me shumë meshkuj. Prandaj, del se këto dënime në të shumtën e rasteve zbatoheshin kundër atyre delikuentëve që rridhnin nga familjet e varfëra e të pafuqishme.

Këtu shihet më së miri karakteri klasor i këtyre ndëshkimeve. Ndëshkimet trupore zakonisht i shqiptonte gjyqi i pleqve. Qëllimi i tyre ishte hakmarrja kundër kryerësit, ndërsa kur zbatoheshin kundër fëmijëve, atëherë këto dënime kishin për qëllim edhe t'i pengonin dhe përmirësonin kryerësit. Në ekzekutimin e ndëshkimeve trupore, pos gjykatësit të gjyqit të pleqve, zakonisht merrnin pjesë edhe prindët, respektivisht të afërmit e familjes së të dënuarit. Ky ekzekutim bëhej duke e goditur të dënuarin disa herë me shkop ose me shuplakë. Në disa vise ekzistonin edhe mënyra të tjera ekzekutimi për këto ndëshkime.⁸⁰

Personave psiqikishtë të sëmurë poashtu u shqiptoheshin dënimet trupore për shkak të veprave të ndryshme penale. Kjo është një kategori e posaçme e delikuentëve sipas të drejtës zakonore, kundër të cilëve ndëshkimet tjera s'do të kishin kurrtarë efekti pozitiv, pasi ata nuk ishin në gjendje të gjykojnë drejt. Sipas të drejtës zakonore, te këta persona mbretërojnë disa instinkte, që mund të mposhten vetëm me rrahje e dajak, sepse frika nga dhëmbjet fizike i detyron këta që të përmbajnë veten dhe të heqin dorë nga kryerja e veprave penale. Meqë sot këta persona në të shumtën e rasteve dërgohen në ente të ndryshme për persona psiqikisht të sëmurë, rastet e zbatimit të dënimeve trupore kundër tyre janë të rralla. Mirëpo, ky botëkuptim është i pranishëm ende, kështu që ne kemi hasur në disa raste të dënimit të këtyre personave, në mënyrë që prej tyre kinëse „të dëbohet ora e keqe“.

Në të drejtën zakonore dënimet trupore më së shpeshti zbatoheshin kundër femrave, të cilat kishin sjellje të palejueshme. Kjo mënyrë e dënimit dhe e sjelljes ndaj femrave i përgjigjej plotësisht pozitës që kishin ato në gjirin e familjes patriarkale dhe të vetë bashkësisë fisnore në përgjithësi. Dënimet më të shpeshta trupore që

⁸⁰ Zakonisht fajtorit ia lidhnin duart dhe këmbët, pastaj i binin me shkop ose me grushta këmbëve dhe fytyrës. Ky është i ashtuquajturi „fallak“, i cili zbatohet sipas të drejtës së Sheriatit.

zbatoheshin kundër femrave ishin rrahja, shëmtimi i fytyrës, qethja e flokëve etj. Mund të themi se këto ndëshkime i ndeshim edhe sot në këto anë, kuptohet më rrallë se dikur. Rrahja e femrës konsiston-te në atë që ajo goditej me shkop, me konop të lagshtë, me rrypa të ndryshëm e kështu me radhë. Shëmtimi i fytyrës bëhej duke u shkak-tuar femrave aso plagë dhe lëndime, të cilat ndikonin që të humbë bukuria dhe hieshia e mëparme e fytyrës së femrës, e pikërisht këto dënime kishin për qëllim mu këtë. Meqenëse në këto vise, si dhe gje-tiu konsiderohej se femrën e bëjnë më të bukur flokët, atëherë si dënim dhe hakmarrje për mëkatet e bëra përdorej edhe qethja e flokëve, madje në trajtë rreshtash, ashtu si qethen dhentë.

Kjo mënyrë e vrazhdët e dënimit të femrave parashihej për disa sjellje, me të cilat turpërohej morali familjar, bashkëshortor dhe seksual. Këto janë, para së gjithash, adulteria, mosrespektimi dhe kundërshtimi i fjalës së burrit, braktisja e bashkësisë shtëpiake për shkak të rimartesës, lënia pas dore e obligimeve të nënës, nxitja dhe shkaktimi i konflikteve në familje, në bashkësi ose në fshat etj. Këto dënime zakonisht i shqiptonte dhe i zbatonte në jetë i zoti i shtëpisë, respektivisht bashkëshorti i asaj femre. Por, në disa raste, kur sjellja e femrës kishte karakter të atillë sa që mund të shkakton-te konflikte brenda vëllazërisë, respektivisht fshatit, atëherë këto dënime i shqiptonte gjyqi i pleqve, i cili njëkohësisht caktonte edhe mënyrën e ekzekutimit të dënimit. Mirëpo, gjyqi i pleqve në këto ra-ste urdhëronte që këto dënime t'i ekzekutojnë prindët, respektivisht bashkëshorti ose i zoti i shtëpisë. Është karakteristike se këto dëni-me, si dhe vetë mënyra e ekzekutimit të tyre, kanë karakter poshtë-ruës, e kjo është në pajtim me botëkuptimet ekzistuese, e veçanërisht me ato që kanë ekzistuar dikur se femra është më pak e vlefshme, prandaj edhe e kanë krahasuar shpesh me të miturit. Kjo mënyrë e dënimit duhej t'u shërbente si shembull femrave të tjera që t'u kenë frikën dhe t'i nderojnë bashkëshortët e vet dhe të gjithë burrat e tje-rë të familjes.

Çështja se a thua këto masa do të zbatoheshin në çdo rast ku-ndër të gjitha femrave, varej shumë nga fakti se cilës familje i ta-konte femra, familjes së pasur apo të varfër, më të fortë ose më të dobët, të nderuar ose të rënë moralisht, çfarë vëllazërie ose fisi etj.

Nga kjo del se vetëm në këto raste vërehet vrazhdësia dhe rreptësia në zbatimin e disa dënimeve trupore në të drejtën zakono-re të shqiptarëve sepse, siç kemi thënë, në të drejtën tonë zakono-re dikur s'ka pasur dënime që mund t'i hasim në të drejtën e popujve të tjerë, si për shembull: gjymtimi, prerja e dorës, e gjuhës, e or-ganeve gjentiale, nxerrja e syve, ndukja e mjekrrës, djegia.⁸¹

⁸¹ Todor Taranovski: *Istorija srpskog prava u Nemanjičkoj državi, II deo* — *Istorija krivičnog prava*, Beograd, 1931, f. 59—63; Lazar Urošević: *Pravosuđe i pisano pravo u Srednjoj vekovnoj Srbiji*, Beograd 1939, f. 175—176.

c) Humbja e të drejtave të nderit,
respektivisht e nderit qytetar

Humbja e nderit qytetar ishte masë që zbatohet poashtu në të drejtën zakonore. Në shumë raste ajo ishte pasojë normale e sjelljeve të caktuara të palejueshme. Kjo masë ishte e ngjashme me leçitjen, nga e cila dallohet vetëm pse një person nuk e leçisin të afërmit, respektivisht njerëzit e fisit të tij, por atij i cënohen disa të drejta, si për shembull: e drejta që të kryejë funksione të caktuara në organet e vëllazërisë, të fshatit, respektivisht të fisit. Mirëpo, ky cënim njëkohësisht do të thotë edhe qeverimin e atij personi nga të tjerët, kështu që sipas kësaj karakteristike mund të flasim për ngjashmërinë e këtyre masave.⁸²

Kjo masë më së shpeshti zbatohet kundër gjyqtarëve të gjyqit të pleqve, bajraktarëve, krerëve dhe funksionerëve të tjerë të vëllazërisë, të fshatit, gjegjësisht të fisit. Kjo masë shqiptohet për ato vepra penale, të cilat shkaktonin rënien e prestigjit të të drejtave të ndryshme zakonore dhe të institucioneve, si për shembull: marrja e ryshfetit, joobjektiviteti, respektivisht gjykimi i njëanshëm, dëmtimi i vëllazërisë ose i fshatit me punë ose marrëveshje të ndryshme, dëshmimi i rremë, shkelja e besës, mosrespektimi i vendimit të kuvendit etj. Në këtë mënyrë, për gjyqtarin e gjyqit të pleqve thuhet se poqese gjykon në mënyrë të njëanshme ose merr ryshfet nga cilado qoftë palë që është në konflikt, përpos asaj që do të jetë i turpëruar, atë kurrë më askush nuk do ta ftojë në gjykim (më gjerësisht për këtë shih paragrafin 1115 dhe 1116 të KLD). Poashtu, për shkak të sjelljeve të këtilla ata nuk kanë mundur të zgjedhen as për anëtarë të porotës e as për profesione të tjera. Sot personat që bëjnë kështu veprash penale nuk mund të zgjedhen anëtarë të këshillave të pajtimit, këshilltarë të fshatit, respektivisht të vëllazërisë e as që mund të kryejnë disa funksione të tjera në jetën shoqërore-politike të fshatit.

Zbatimi i kësaj mase dikur, e shpeshherë edhe sot, tërheq pas vetes edhe disa pasoja të tjera, siç është p.sh. leçitja e të dënuarit, respektivisht e familjes së tij. Pos kësaj, këta persona nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në solemnitetet e ndryshme në vende të caktuara, me fjalë të tjera ata liheshin pas dore në çdo pikëpamje. Një sjellje e tillë e rrethit shoqëror i goditte shumë këta persona, sepse në këto rrethana më së shumti manifestohej pështja dhe mosbartja e dënimeve të këtilla. Shpesh këta persona bëhen objekt përqeshjeje, delendisjeje e kështu me radhë, gjë që e keqësonte edhe më tepër gjendjen e tyre në atë rreth shoqëror. Ndonjëherë, për shkak të provokimeve të këtilla, këta persona reagonin rreptë, madje shpeshherë me vrasje dhe lëndime të rënda trupore.⁸³

⁸² Sh. K. Gjeçovi: *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Shkodër, 1930, (§1015).

⁸³ Nuk janë të rralla rastet që individët për shkak të kritikës për humbjen e disa të drejtave në kuadër të fshatit respektivisht vëllazërisë, reagojnë shumë ashpër madje dhe bëjnë shumë vrasje.

Aty-këtu në rrethet fshatare, ku religjioni ushtron ndikim të madh, mund të vërehen edhe dënimet me karakter religjioz që janë të ngjashme me ato të mëparshme. Kështu, për shembull, shpesh përdoret mallkimi, respektivisht anatema, ndalimi i pjesëmarrjes në ceremonitë kishtare, pengimi i sendërtimit të disa të drejtave si, për shembull, të të falurit, të varrimit, të kurorëzimit etj. Këto masa sot nuk e kanë rëndësinë e vet të dikurshme, por sido qoftë ato i ndeshim shpesh. Personat e dënuar me këto dënime nuk mund të kryejnë një varg punësh dhe funksionesh në fshatin, respektivisht në vëllazërinë e vet. Është interesante të theksohet se këto masa kanë rëndësi më të madhe dhe konsiderohen si shumë më të rënda në pjesën katolike të popullsisë, e më pak të rëndësishme dhe jo aq të rrepta në qarqet muslimane dhe ortodokse.⁸⁴

ç) Qortimi, respektivisht tërheqja e vërejtjes

Qortimi është një ndër masat e shpeshta që zbatohet në të drejtën zakonore dhe për të s'mund të themi se paraqet një sanksion në kuptimin e ngushtë të fjalës, edhe pse sipas mendimit tonë ai është një lloj sanksioni në kuptimin më të gjerë të fjalës. Qortimi konsistonte në atë që gjyqi i pleqve i fshatit ose i vëllazërisë ia tërhiqte vërejtjen seriozisht e sinqerisht kryerësit të ndonjë sjellje të palejueshme, në atë mënyrë, që ia bënte me dije pasojat eventuale të një siellje të atillë dhe kërkonte nga ai ose nga burrat e shtëpisë së tij që në të ardhmen të mos e përsërisin një sjellje të këtillë. Ky është një lloj shqyrtimi i sinqertë i gjendjes në çastin e lindjes së konflikteve të mundshme dhe si i këtillë paraqet një masë të shkëlqyeshme preventive, me të cilën pengohen veprat e ndryshme penale dhe deliktet e tjera brenda vëllazërisë ose fshatit. Kjo masë zbatohet më së shpeshti për ato siellje që nuk janë aq të rrezikshme, por të cilat më vonë mund të shkaktojnë pasojat e ndryshme të rënda. Këto janë më së shpeshti fryerja, shpifja, dëmtimi i ndonjë gjëje oce i paturisë së huaj, mospërfillia e obligimeve të marrëveshjeve të ndryshme, e më së shpeshti të marrëveshjeve për shitblerjen e tokës, të marrëveshjes për kurorëzim, respektivisht martesë etj. Masën e qortimit, në rastet e zakonshme e shqipton gjyqi i pleqve. Mirëpo, në disa raste të posaçme, këtë masë mund ta shqiptojnë edhe individët, të cilët konsiderohen si qytetarë autoritativë të atij rrethi shoqëror.

*
* *
*

Këto janë sanksionet më të rëndësishme sipas të drejtës zakonore që zbatoheshin dikur, e vende-vende ato zbatohen edhe sot në Kosovë. Natyrisht, numri i këtyre sanksioneve në të kaluarën ishte

⁸⁴ Đorđe Milović: *vep. e cit.* f. 340—356.

më i madh, por ne u ndalëm vetëm tek ato që zbatoheshin më së shumti dhe që si të atilla vlenin deri vonë.

III. PASOJAT E ZBATIMIT TË SANKSIONEVE PENALE SIPAS TË DREJTËS ZAKONORE

Shtimi i numrit të delikteve të gjakut dhe i dukurisë së veçantë të gjakmarrjes në krahinën e Kosovës, viteve të fundit ka pasoja të shumta negative shoqërore. Në këtë mënyrë, vetëm në pesë-gjash-të vitet e fundit ka pasur rreth 700 vrasje dhe afro 1000 lëndime trupore. Për shkak të rregullave të vjetra zakonore lidhur me gjakmarrjen, sot në Kosovë ka rreth 605 familje të mbyllura në të ashtuquajturin „burgun shtëpiak”. Këto familje numërojnë afro 57 000 anëtarë, ndërsa disponojnë rreth 3000 hektarë tokë të punueshme.⁸⁵

Se sa negative dhe të rrezikshme janë disa dukuri të së drejtës zakonore që kanë të bëjnë me dënimin në një pjesë të popullsisë fshatare, më së miri na e ilustron një rast i vrasjes për shkak të gjakmarrjes që ndodhi kah fundi i vitit 1971 në fshatin Landrovc afër Prizrenit. Në të vërtetë, këtu për shkak të hakmarrjes për lëndimin trupor dhe për vrasjen e mëparshme, u vranë dy fëmijë të mitur, njëri 14, kurse tjetri 12 vjeç. Ky krim, duke qenë se u bë kundër fëmijëve, paraqet një presedan në kryerjen e gjakmarrjes. Kjo për arsye se sipas rregullave të së drejtës zakonore, ajo duhet të bëhet me trimëri, e jo me dinakëri, duhet të kryhet kundër burrave të shëndoshë, e jo kundër fëmijëve, siç ndodhi me këtë rast. Kjo është njëkohësisht edhe forma më e vrazhdët e deformimit të gjakmarrjes, ky është eksces i gjakmarrjes. Për këtë arsye, kjo gjakmarrje zgjoi dënimin unanimit të opinionit të krahinës. Ky rast njëkohësisht dëshmoi se sa e rrezikshme dhe e dëmshme është në kushtet e sotme mënyra e vjetër e reagimit, e kërimit arbitrar të së drejtës. Prandaj, në kuadër të kësaj pjese do të përpiqemi t'i shqyrtojmë shkurtimisht këto pasoja.

Gjakmarrja si dënim dhe hakmarrje sot kushtëzon humbjen e jetës së një numri të madh të anëtarëve të bashkësisë sonë; ajo ndikon në shtimin e numrit të veprave penale të vrasjes. Këtë dukuri që na brengos, dëshmojnë edhe të dhënat statistikore që i paraqitëm më lart për numrin e vrasjeve të bëra etj. Poashtu lypset të theksohet se zbatimi i kësaj mase më së shumti i godit përfaqësuesit e kombësisë shqiptare. Kjo shihet, për shembull, nga këto të dhëna: përbërja nacionale e kryerësve të vrasjeve në periudhën prej vitit 1957 deri më 1968 në Kosovë është kjo: shqiptarë 83%, serbë 9,7%, malazezë 3,5%, turq 1,2% e të tjerë.⁸⁶

⁸⁵ Raporti i Sekretariatit Krahinor të Punëve të Brendshme lidhur me deliktet e gjakut në territorin e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës për vitet: 1966, 1968 dhe 1970.

⁸⁶ Hajredin Hoxha: *Neke sociološke karakteristike krvne osvete kod Albanaca u Jugoslaviji*, Jugoslovenska revija za kriminologiju i krivično pravo (JRKK) Beograd, nr. 4. 1971, f. 608—609.

Për këtë arsye, shpesh me të drejtë shtrohet pyetja dhe shprehet brengosja se pse ka aq shumë vrasje dhe delikte të tjera të rënda të gjakut, kështu që në këtë drejtim krahasohet numri i viktimave të vrasjeve në Kosovë dhe i viktimave të disa luftave lokale në botë. Kuptohet se këto krahasime në disa raste janë të arsyeshme, ndërsa në të tjerat qëllimkeqë, por pa marrë parasysh këtë është fakt se këto vepra penale janë në shtim e sipër dhe se paraqesin një problem të posaçëm, i cili kërkon zgjidhje serioze dhe të shpejtë.

Ky sistem i reagimit privat, respektivisht jozyrtar i disa personave dhe bashkësive familjare, u shkakton vështirësi të mëdha materiale. Kjo për arsye se pas kryerjes së veprës penale të vrasjes ose të lëndimit trupor, farefisi, respektivisht familja e kryerësit duhet të mbyllet në të ashtuquajturin burgun shtëpiak. Atyre u bëhet i pamundur punimi i tokës dhe kryerja e rregullt e veprimtarive të tjera punonjëse dhe prodhuese. Në këtë mënyrë rrezikohet reproduksioni normal i prodhimeve themelore dhe plotësimi i nevojave të zakonshme të popullsisë me këto prodhime.⁸⁷

Kjo gjendje ndikon në keqësimin e standardit të shumë familjeve dhe individëve. Sistemi i pajtimit ose masat e dëbimit, respektivisht të shpërnguljes, në shumë raste janë të paarsyeshme dhe godisin rëndë disa familje të këtyre anëve. Ndonjëherë, individët, respektivisht familjet, shesin tërë drithin, pasurinë e tundshme e të patundshme, që t'i paguajnë avokatët, çmimin e pajtimit, e kështu me radhë. Edhe pse në këto raste duket se u zgjodhi një konflikt, sidoqoftë në anën tjetër shfaqen probleme të tjera edhe më të vështira me karakter material, respektivisht social, sepse shpeshherë nga këto familje dalin kriminelët, endacakët, djerraditët etj.

Praktika e gjyqit të pleqve në këtë drejtim shpesh e ka ngarkuar jetën shoqërore të këtyre anëve me dukuri të ndryshme negative.⁸⁸ Kështu, për shkak të metodave të këtilla të dënimit, një numër mjaft i madh njerëzish mbetet jashtë procesit të punës së përditshme shoqërore-politike dhe mundësisë së kryerjes së aktiviteteve të ndryshme. Në këtë mënyrë, një numër i konsiderueshëm fëmijësh dhe të rinjsh është i detyruar të ndërpresë shkollimin e rregullt, respektivisht studimin, e një numër punëtorësh dhe nëpunësish mungojnë nga puna një kohë të gjatë e madje ka raste kur ata largohen përgjithmonë nga vendi i punës.

Këto masa të reagimit lanë pasoja të rënda edhe në lidhjet dhe marrëdhëniet farefisnore. Nuk janë të rralla rastet kur për shkak të zbatimit të këtyre masave, shumë vetë duhet të çkurorëzohen, të shpërngulen nga vendi ku jetojnë kushërinjtë e tyre më të afërt, gjë që gjithashtu godit rëndë njerëzit, të cilët janë mësuar të jetojnë

⁸⁷ Shihet qartë se këto familje shkatërrohen shpejt në pikëpamje ekonomike. Ato janë aq të varfëra sa që është vështirë të pritët ndonjë zhvillim i drejtë i tyre. Prandaj nuk është aspak çudi që te këto mortaliteti i fëmijëve dhe i personave të moshuar është dukuri mjaft e shpeshtë. Poashtu janë të pranishme edhe sëmundjet e ndryshme, të cilat shfaqen si pasojë e ushqimit të pamjaftueshëm dhe e atmosferës së acaruar të jetës.

⁸⁸ R. Halili: *Pleçnija u Zakoniku Leke Dukadinija*, Anali pravnog fakulteta u Beogradu, nr. 5. 1970, f. 542.

gjithmonë në bashkësi, në marrëdhënie reciproke normale e të afërta. Shpeshherë ndodh të ndërpriten lidhjet farefisnore ose miqësore ose që disa familjeve dhe individëve t'u refuzohet solidarësia vëllazërore, respektivisht fshatare, gjë që pasqyrohet shumë keq në këto marrëdhënie. E tërë kjo ndikon në shfaqjen e deformimeve të ndryshme psikike e sociale. Në këtë mënyrë, te individët e familjet manifestohen cilësi dhe karakteristika të ndryshme negative e jo të shëndosha. Kështu p. sh. lind urrejtja, egoizmi, rivaliteti, shfaqen psiko-neuroza të ndryshme, ndjenja e frikës etj. Nga ky aspekt shfaqet një bindje e posaçme për joefikasitetin e organeve shtetërore që të zgjidhin problemet themelore të jetës së njerëzve, kështu që shpesh formohet opinioni publik, i cili mohon plotësisht mundësitë e intervenimit të organeve kompetente shtetërore në këtë drejtim.

Në kushtet e ekzistimit të një mënyre të këtillë të dënimit, shumë vështir dhe ngadalë po depërtojnë botëkuptimet e reja dhe përparimtare për qëllimin e sanksioneve bashkëkohore penale dhe për të „drejtën” e „drejtësinë” etj.⁸⁹ Kjo për arsye se mënyra e vjetër e reagimit kundër sjelljes kriminale ndikon në konservimin dhe ruajtjen e disa formave të vjetra dhe të tejkaluara të reagimit, të cilat ishin karakteristike për formacionet e mëparme shoqërore-ekonomike.

Përsa i përket kësaj, duhet theksuar një paralelizëm karakteristik dhe një dualizëm të ekzistencës e të veprimtarisë së të dy sistemeve ndëshkimore: sistemit të vjetër, sipas të drejtës zakonore dhe atij të ri, sistemit juridiko-pozitiv të dënimit. Këto dy sisteme ose mënyra dënimi janë aq kontradiktore, sa që është çudi e madhe se si kanë mundur të koekzistojnë në kushtet e sotme.

Derisa sistemi i parë, gati në të gjitha rastet, bazohet mbi hakmarrjen kundër kryerësit si qëllim të vetëm, sistemi i dytë zbatimin e dënimit e sheh si një masë përmirësimi dhe risocializimi të kryerësve të veprave penale dhe si masë që do të veprojë e ndikojë në mënyrë edukative mbi qytetarët e tjerë. Këtu qëndron edhe ndryshimi esencial midis këtyre dy sistemeve, duke përmendur me këtë rast faktin e njohur mirë se sistemi i parë shfaqet si formë e reagimit privat në krahasim me sistemin e dytë, i cili na shfaqet si formë publike juridike e reagimit kundër kriminalitetit.

Sanksionet penale sipas të drejtës zakonore në Kosovë, dallohen për shumë arsye nga sanksionet penale me karakter pozitiv juridik. Shumicën e këtyre sanksioneve nuk e njeh e drejta pozitive dhe legjislatura as e vendit tonë e as e vendeve të tjera. Mirëpo, përkundër kësaj, sanksionet e së drejtës zakonore ende janë të pranishme e madje edhe ushtrojnë një ndikim të caktuar mbi këto të dytat. Kjo shihet më së miri atëherë kur gjyqi, me rastin e caktimit të dënimit, merr parasysh pajtimin e palëve dhe gati gjithmonë shqipton dënime më të buta se zakonisht.

⁸⁹ R. Halili: *Qëllimi dhe arsyeja e dënimit për krimet e vrasjes*, Përparimi nr. 6, 1970 f. 564—565.

Ndonjëherë, kryerësi ose familja e tij dënohen për të njëjtin faj dy herë: herën e parë sipas ligjeve pozitive-juridike e herën e dytë sipas rregullave zakonore. Kështu, për po atë vepër penale jipet përgjegjësia e dyfishtë. Duhet theksuar se shpeshherë ndikojnë shumë më tepër dhe kanë efekt më të madh dënimet e së drejtës zakonore se sa ato të së drejtës pozitive-juridike. Lidhur me këtë është interesant të theksojmë edhe rastet kur gjyqi shtetëror mund të dënojë p. sh. vrasësin me dënimin me vdekje ose me ndonjë dënim më të rreptë kohor, e që kjo të mos ketë kurrfarë rëndësie për palët që janë në konflikt, sepse pala e dëmtuar do të përpiqet me çdo kusht të hakmerret vetëm poqese gjyqi i pleqve nuk arrin që t'i pajtojë përmes kompensimit ose ndonjë mënyre tjetër. Një situatë të ngjashme kemi atëherë kur për një lëndim trupor, gjyqi i rregullt i shqipton kryerësit një dënim të caktuar, por pala tjetër që është në konflikt nuk e pranon këtë dënim e as që konsideron se situata konfliktoze ka marrë fund, prandaj të dy palët sillen ashtu thua se vendimi i gjyqit nuk i obligon aspak. Ose rasti tjetër: gjyqi i dënon individët, por ky dënim s'ka ndonjë rëndësi të madhe sepse familjet që janë në konflikt janë pajtuar dhe konfliktin e kanë zgjidhur në mënyrë paqësore.

Kjo praktikë e zbatimit të sanksioneve zakonore ndikon mjaft në uljen e prestigjit të gjyqit të rregullt dhe në mosrespektimin e vendimeve të tij që kanë të bëjnë me sanksionet penale. Kjo ngjan për arsye se shpeshherë këto vendime s'kanë kurrfarë efekti e as që në këto raste mund të bëhet fjalë për sendërtimin e qëllimit të këtyre masave.⁹⁰ Poashtu, kjo mënyrë e dënimit, si edhe vetë sistemi i të drejtës penale zakonore ngadalëson procesin e depërtimit e sistemit të ri penal-juridik në vetëdijën e masave të gjera fshatare, gjë që ka për pasojë ruajtjen dhe zbatimin e mëtejshëm të disa zakoneve dhe rregullave prapanike. Kjo gjë poashtu pengon procesin e ndryshimeve progresive shoqërore-kulturore në këto rrethe shoqërore. Në disa raste, këto tendenca janë aq të pranishme dhe aq të theksuara sa që shpeshherë shpien drejt njëlloj anarkie.

Qëllimi themelor pothuaj i të gjitha sanksioneve penale zakonore është hakmarrja kundër kryerësit dhe jo vetëm kundër tij, por edhe kundër të afërmeve të tij të gjakut. Karakteri i hakmarrjes është i pranishëm gati në të gjitha format e reagimit kundër sjelljeve kriminale të individëve ose të familjeve. Kjo shihet si te zbatimi i dënimeve më të rënda, siç janë gjakmarrja, dëbimi, konfiskimi i pasurisë etj., ashtu edhe te format më të lehta të reagimit, siç janë: leçitja, qortimi, dënimi në të holla etj. Derisa te të parat, karakteri i hakmarrjes është i dukshëm dhe ai manifestohet shpesh në trajtën e saj më vulgare, te të dytat qëllimi i hakmarrjes deridiku është i fshehur, jo aq i dukshëm, nuk manifestohet në formën e saj të jashtme dhe shpesh të lë përshtypjen se aty nuk kemi të bëjmë me hakmarr-

⁹⁰ R. Halili: *Artikulli i cituar f. 566–567.*

jen, madje as në formën e saj më të butë. Mirëpo, kështu mund t'u duket vetëm atyre që nuk i njohin këto rrethana, si dhe laikëve për këto rregulla zakonore. Kështu, p. sh. s'mund të themi se nuk ka hakmarrje me rastin e pajtimit sipas vendimit të gjyqit të pleqve, poqese familja e kryerësit, ose ai vetë, i japin si revanshim familjes së viktimës ndonjë gjë, e cila, në e parë, duket e parëndësishme, por që, sipas së drejtës zakonore dhe botëkuptimit të përgjithshëm të atij rrethi shoqëror, paraqet në pikëpamje simbolike një vlerë të madhe, si për shembull: ora e xhepit, pushka, kali i shalës etj.⁹¹

Kjo e godit aq fort kryerësin, respektivisht familjen e tij, sa që ai e ndien veten përgjithmonë të turpëruar, të përulur e të poshtëruar para rrethit shoqëror dhe opinionit publik. Këtë situatë e njeh mirë familja e viktimës dhe për këtë arsye pranon t'i paguhet gjoba sepse në këtë mënyrë fiton satisfaksionin, i cili shpeshherë barazohet edhe me vetë hakmarrjen. Kjo paraqet për të një kënaqësi shpirtërore dhe një shkarkim psiqik, kurse në raport ndaj rrethit shoqëror, respektivisht opinionit publik, një dëshmi morale dhe nderim. Me fjalë të tjera, në këto raste është i pranishëm parimi i njohur i hakmarrjes, i kthimit të së keqes me të keqe. Kjo është në pajtim me konceptin e të drejtës dhe të drejtësisë në këto anë, botëkuptim ky që, pos hakmarrjes, nuk ka kurrfarë qëllimi tjetër.

Siç shihet, dënimet dhe të gjitha masat e së drejtës zakonore kanë për qëllim ta godisin njësoj si kryerësin, dhe familjen e tij ashtu edhe farefisën e tij më të afërt të gjakut, kurse të tjerëve t'u fusin frikën, kështu që të mos guxojnë të veprojnë në mënyrë të ngjashme. Një pikëpamje e këtillë mbi sanksionet penale është e gabueshme dhe, në esencë, e dëmshme. Kjo, para së gjithash, për shkak se tek njerëzit nxit kërkesën dhe dëshirën për hakmarrje dhe për arsye se kjo praktikë pengon trajtimin e drejtë e human të jetës. Për shkak të një trajtimi dhe koncepti të tillë të qëllimit të dënimit, shpeshherë vendimet e gjyqit të rregullt kundër kryerësve të veprave penale injorohen, nuk pranohen, ato për ta nuk ekzistojnë ose, tek e fundit, këto dënime nuk i pengojnë që të ndër marrin aksione të ndryshme hakmarrjeje.

Ky sistem i dënimit në shumë raste pengon punën dhe ndikimin e drejtë të gjyqit të rregullt dhe të institucioneve e organizatave shoqërore-politike në disa fshatra. Rastet e ndryshme dhe konfliktet e ashpra që krijohen para ose pas zbatimit të këtyre masave, neutralizojnë punën e organeve e të institucioneve të përmendura. Në këtë mënyrë, në shumë qarqe fshatarake e malore njeriu fiton përshtypjen se kujdesi themelor e kryesor i popullsisë është si të ruhet nga gjakmarrja dhe nga disa dukuri të tjera, ndërsa shumë pak flitet për disa probleme më të rëndësishme, për përparimin e bujqësisë, për analfabetizmin, për instalimin e rrymës elektrike, për ndërtimin e shkollave etj. Nga kjo rrjedh se prania e dënimit sipas së

⁹¹ R. Halili: *Vrasjet për hakmarrje*, Përparimi, nr. 5, 1969, f. 390—391.

drejtës zakonore i rëndon fort marrëdhëniet e fshatit dhe shpeshherë paraqet një pengesë serioze për zhvillimin dhe transformimin më të shpejtë të fshatit.

Poashtu edhe organet e pushtetit dhe të jurisprundencës janë të angazhuara shumë me problemet që i krijon sistemi i përmendur ndëshkimor. Kështu, duket sikur organet tona të jurisprundencës dhe organizatat shoqërore-politike të këtyre viseve nuk bëjnë gjë tjetër dhe merren vetëm me këto probleme, gjë që s'është e vërtetë.

Për shkak të kësaj gjendje, në shumë qarqe fshatarake shkaktohet ndasia dhe përçarja midis njerëzve. Si pasojë e kësaj, dobësohet solidarësia reciproke, kështu që shumë punë dhe aksione me interes të përbashkët mbeten të pakryera dhe shtyhen, sepse s'ka bashkim e unitet. Kjo është shkaktuar për arsye se konfliktet e përmendura nuk janë zgjidhur drejt sipas rregullave zakonore. Në këtë drejtim shpesh vërehet rivaliteti ndërmjet familjeve të ndryshme, i cili zgjat shumë kohë. Nuk janë të rralla rastet kur rrugët e fshatit dhe objektet e tjera të përbashkëta nuk mund të ndërtohen për shkak të konflikteve reciproke, për arsye të hakmarrjes, leçitjes ose dënimeve të tjera.

Se sa e vështirë është kjo na e dëshmojnë edhe disa situata kur ishte fjala për caktimin e vendit për ndërtimin e shkollës, respektivisht të ambulancës, ku me muaj të tërë s'ka mundur të fillojë ndërtimi për shkak të këtyre mosmarrëveshjeve.

Zbatimi i disa sanksioneve të tilla penale të së drejtës zakonore në këto anë paraqet shkeljen e sistemit juridik-pozitiv. Në këtë mënyrë, shumë personave e familjeve u cënohen të drejtat dhe liria e garantuar me kushtetutë dhe me ligj. Dimë se të gjithë qytetarëve të vendit tonë u garantohet e drejta e qarkullimit të lirë, e drejta e procedurës dhe e gjykimit ligjor, e drejta e mbrojtjes, e drejta e pronës private etj. Poashtu dimë se në vendin tonë vetëm e vetëm gjyqi është i autorizuar t'i gjykojë dhe t'u shqiptojë dënimin kryerësve të veprave penale. Mirëpo, duke zbatuar sanksionet e së drejtës zakonore, këto të drejta dhe liri të qytetarëve shkilen në mënyrë të vrazhdët. Kështu, për shembull, kjo mund të shihet qartë në vendimin e gjyqit të pleqve për dëbimin e dikujt nga fshati, në kufizimin e qarkullimit të lirë gjatë leçitjes, në ekzistimin e të ashtuquajturit burgut shtëpiak, e të mos flasim për gjakmarrjen. Për shkak të një gjendje të këtillë, siç kemi theksuar edhe më parë, shumë persona nuk mund t'i realizojnë disa të drejta legjitime, si për shembull të drejtën e punës, të drejtën e shkollimit, të drejtën e disponimit të lirë të pronës private etj.

Kjo dukuri bëhet edhe më e rëndësishme kur dimë se kjo mënyrë e reagimit zbatohet dhe ekziston edhe më tutje në kushtet e ndërtimit tonë socialist dhe në kohën e zbulimeve të mëdha spektakulare ku, përndryshe, këto mbeturina të mënyrës së vrazhdët të reagimit s'e kanë vendin fare.

Mënyra dhe karakteri i reagimit sipas së drejtës zakonore ndikojnë shumë në ruajtjen e mëtejme të botëkuptimit se gjakmarrja dhe disa delikte të tjera të gjakut në krahinën tonë mund të evitohen vetëm e vetëm me anën e masave represive. Në këtë mënyrë, te një pjesë e popullsisë fshatare është krijuar një opinion i atillë publik, i cili vazhdimisht insiston dhe ushtron presion të caktuar mbi organet e jurisprudencës dhe të pushtetit që me çdo kusht, për të gjitha deliktet e gjakut, të zbatohet dënimi me vdekje dhe që ai të ekzekutohet me varrje publike të kryerësit, e poashtu të zbatohen masat e rrepta kundër të afërmeve dhe familjes së kryerësit. Ky botëkuptim ka marrë aq hov të madh, sa që çdo vendim i gjyqit për dënimin kohor të kryerësit të deliktit të gjakut konsiderohet si veprim me qëllim i butë i organit të jurisprudencës kundër këtyre kryerësve. Prandaj, nuk janë të rralla rastet kur gjyqit dhe organeve të tjera u bëhet vërejtja se ata, me një politikë të këtillë ndëshkimore, me qëllim nxisin sjelljet kriminale. Kjo bëhet për arsye se çdo dënim tjetër, pos dënimit me vdekje për disa delikte të gjakut, paraqet vetëm një nxitje të re për kryerësit potencialë të tyre. Natyrisht, ky koncept është në pajtim me konceptin e dënimit si hakmarrje.⁹²

Ekzistimi i mëtejme i disa sanksioneve sipas së drejtës zakonore paraqet një pengesë serioze për afirmimin kombëtar të një pjesë të popullsisë shqiptare të kësaj krahine. Kjo ndodh kështu, para së gjithash, për arsye se një problematikë e tillë i preokupon shumë forcat përparimtare dhe, në këtë mënyrë, pengon transformimin më të shpejtë kulturor e ekonomik të këtyre viseve. Serioziteti i kësaj dukurie shihet më së miri nga bisedat dhe diskutimet që mbahen sot në shumë vende të krahinës sonë. Çdo intelektual i kësaj kombësie konsideron se zakoni i gjakmarrjes dhe dukuritë e tjera me karakter të ngjashëm me këtë, sot paraqesin një pengesë serioze për afirmimin e mëtejme të kësaj kombësie në Jugosllavi. Këtë e vërtetojnë edhe të dhënat që i përmendëm më parë në këtë punim për numrin e vrasjeve, numrin e familjeve të mbyllura etj., ku me dhjetra persona për çdo ditë frikësohen se mos bëhen viktimat e hakmarrjes. Kjo psikologji e pritjes së përhershme të gjësë më të keqe i godit me mijëra anëtarë të kombësisë sonë, gjë që ka për pasojë shfaqjen e deformimeve dhe të sëmundjeve të ndryshme psikike.

Evitimi i pasojave të dëmshme të këtyre masave

Nga shqyrtimi i deritashëm del se zbatimi i mëtejme i disa sanksioneve sipas së drejtës zakonore shkakton pasoja të ndryshme negative, kështu që shtrohet çështja e mënyrës së eliminimit të këtyre masave në kushtet tona, por, nga ana tjetër, poashtu shihet se disa masa janë deri diku të dobishme për evitimin e delikteve të caktuara të gjakut dhe të zakoneve të tjera negative të këtyre viseve.

⁹² R. Halili: *Qëllimi dhe arësyeja e dënimit për krimet e vrasjes*, Përparimi nr. 5, 1970, f. 565.

Për këtë arsye, ne do të përpiqemi të theksojmë se ç'duhet ndërmarrë, me qëllim që të evitohen pasojat e dëmshme të këtyre sanksioneve.

Siç dihet, në mënyrë që një dukuri e dëmshme, respektivisht negative të pengohet dhe të zhduket, është e domosdoshme të njihen kushtet dhe shkaqet që i korespondojnë, respektivisht që e shkaktojnë atë dukuri, sepse në këtë mënyrë lufta kundër saj do të jetë më e lehtë. Pasi si kushte dhe shkaqe të dukurisë së delikteve të gjakut dhe zbatimit të sanksioneve zakonore konsiderohet një numër i madh faktorësh si me karakter ekonomik, social, ashtu edhe kulturor-edukativ dhe juridiko-politik, atëherë në tekstin e mëposhtëm gjithsesi duhet të paraqesim se cilët janë këta faktorë dhe si duhet evituar ndikimin e tyre negativ.⁹³

Fakti që politika e deritashme ndëshkimore e gjyqit të rregullt nuk ka dhënë rezultatet e duhura, nuk do të thotë se ajo ka ndihmuar plotësisht ruajtjen e masave të vjetra të reagimit. Kjo ngjan kështu, sepse represioni paraqet vetëm një mënyrë të veprimit kundër kriminalitetit. Prandaj, shoqëria nuk duhet dhe nuk guxon të mbështetet vetëm mbi të. Përkundrazi, duke u nisur prej konceptionit të materializmit historik, të krijimit dhe të veprimit të dukurive shoqërore në këtë drejtim, para së gjithash duhen zgjidhur një varg problemesh me karakter ekonomik-material, të cilat ndikojnë më së shumti mbi ruajtjen e marrëdhënjeve të vjetra në mesin tonë.

Është fakt i pamohueshëm se krahina e Kosovës është pjesa më e pazhvilluar e vendit tonë. Kjo prapambetje shihet më së miri këtu: nga 1 244 000 banorë, janë të inkuadruar afro 106 000, me të ardhura personale mesatare rreth 125 000 dinarë të vjetër. Këto janë të dhënat e vitit 1971.⁹⁴ Pjesa dërmuese e banorëve merret me bujqësi.

Pronat bujqësore individuale janë të vogla, kurse viteve të fundit, për shkak të shkatërrimit të bashkësive të vjetra shtëpiake patriarkale, po bëhet ndarja e mëtejme e këtyre parcelave edhe ashtu të vogla, gjë që poashtu po keqëson pozitën materiale të një numri të madh familjesh fshatare. Kjo gjendje ndikon shumë që dukuritë e ndryshme negative edhe tash e tutje të ruhen edhe në këto vise. Për këtë arsye, përmirësimi i pozitës materiale të popullsisë është faktor i domosdoshëm që do të ndikonte pozitivisht mbi mënjanimin e sanksioneve zakonore negative.

Pjesa dërmuese e popullsisë fshatare, ku zakonisht janë të pranishme këto dukuri dhe ku zbatohet e drejta zakonore është analfabete (rreth 60%). Vetvetiu shtrohet si detyrë e të gjithë faktorëve shoqërorë që kjo gjendje të tejkalohet. Kjo është e domosdoshme, sepse ndikimi i botëkuptimeve dhe i zakoneve të vjetra është më i

⁹³ R. Halili: *Shkaqet dhe kushtet shoqërore ekonomike të krimit të vrasjes nga neni 135 i KP.*, referat i paraqitur në Këshillimin e dhjetë të Shoqatës jugosllave për të drejtën penale dhe kriminologji, mbajtur në Prishtinë në tetor 1971, f. 3—7, 10—12.

⁹⁴ Milenko Karan: *Psihološka priroda krvne osvete*, Jugoslovenska revija za kriminologiju i krivično pravo, nr. 4, 1971, f. 624—625.

fortë dhe më i përhershëm në ato vende, ku alfabetizimi dhe arësimi janë në nivel më të ulët dhe anasjelltas.⁹⁵

Efikasiteti i pamjaftueshëm i gjyqeve në zgjidhjen e konflikteve të ndryshme midis qytetarëve, poashtu kontribuon që këto masa të reagimit të qëndrojnë edhe më tutje, e madje në mënyrë indirekte të ndikojnë në shtimin e numrit të delikteve të gjakut. Për këtë arsye shfaqet nevoja që gjyqi të angazhohet më tepër në zgjidhjen e këtyre konflikteve. Në këtë mënyrë do të pengohej që konfliktet e vogla të shndërrohen në qerime hesapesh në përmasa të mëdha dhe vepra më të rënda penale. Në disa raste, gjyqi, me rastin e gjykimit të disa delikteve të gjakut, ka për detyrë që palët në konflikt t'i udhëzojë e t'i këshillojë lidhur me atë se në ç'mënyrë mund të sendërtojnë kërkesën materiale-juridike, edhe pse kjo punë është mjaft e komplikuar. Do të ishte mirë sikur gjyqi të vepronte kështu sipas detyrës zyrtare, respektivisht pa kërkesën formale të të dëmtuarit, respektivisht të familjes së tij, sepse kërkesat e këtilla zakonisht nuk i parashtrihen gjyqit për shkak se sipas së drejtës zakonore kjo gjë konsiderohet si punë e palejueshme dhe e turpshme. „Gjaku dhe fytyra nuk mund të paguhen me të holla”. Kjo do të mund të shqyrtohej në të ashtuquajturën procedurë adhezioni, pa e mbajtur seancën gjyqësore civile, siç praktikohet sot, sepse kjo seancë s'do të mbahet kurrë për shkak të shkaqeve që i përmendëm, kështu që më këtë rast iniciativa e gjyqit është shumë e dobishme.

Rol shumë të rëndësishëm në mënjanimin e anëve negative të kësaj dhe të dukurive të tjera negative në këto vise luajnë edhe organet e punëve të brendshme. Në kuadër të autorizimeve të veta ligjore, ato duhet të përpiqen t'i zbulojnë dhe t'i evitojnë shkaqet e këtyre dukurive qysh në zanafillën e tyre. Në këtë drejtim, ato duhet të mbajnë evidencën e të gjitha konflikteve dhe të grindjeve, të cilat zakonisht shndërrohen në vepra të rënda penale. Përpos asaj që do të mbanin me rregull këtë evidencë, ato do të duhej të ndërmerren edhe disa masa preventive konkrete, si për shembull t'i ftojnë palët që janë në konflikt që të pajtohen, t'u tregojnë mundësitë ligjore të zgjidhjes së konflikteve, të tregojnë pasojat e dëmshme të një sjellje të këtillë dhe t'i njohin me pasojat që shkaktohen në këto situata. Përveç kësaj, ato do të duhej t'u tërheqnin vërejtjen seriozisht atyre personave, të cilët kërcnohen ose eventualisht mendojnë të kryejnë ndonjë vepër penale. Organet e punëve të brendshme duhet t'i

⁹⁵ Kjo më së miri shihet nga të dhënat që do t'i shenoj më poshtë lidhur me përgatitjen shkollore të kryerësve të veprave penale të vrasjes për gjakmarrje në krahinën tonë për periudhën 1. I. 1957 — 31. XII. 1969:

— pa përgatitje shkollore	186 ose	29,7%
— me shkollë fillore jo të plotë	219 „	35%
— me shkollë fillore	179 „	28,6%
— me shkollë të mesme jo të plotë	24 „	3,8%
— me shkollë të mesme	16 „	3,6%
— me shkollë të alrtë	1 „	0,2%
— me fakultet	1 „	0,2%

(Marrë nga pasqyra e vrasjeve të bëra në territorin e KSA të Kosovës prej 1 janarit 1957 gjer më 31 dhjetor 1969), Prishtinë 10. VI. 1970.

kushtojnë kujdes të posaçëm zbulimit dhe marrjes së armëve të zjarrit, të cilat mbahen pa leje dhe që përdoren më së shpeshti për kryerjen e veprave penale madje edhe për një shkak fare të vogël. Mu kjo u lehtëson punën organeve të punëve të brendshme gjatë marrjes së armëve.

Për evitimin dhe mënjanimin e suksesshëm të anëve negative të këtyre masave në këto vise, nuk mjafton vetëm ndjekja penale e kryerësit të veprës penale, por, sipas mendimit tonë, duhet të ndiqen edhe ata persona, të cilët në një mënyrë ose në një tjetër i kontribuojnë kryerjes së këtyre veprave. Dihet që te vrasjet për shkak të gjakmarrjes dhe te veprat e tjera penale për qëllime hakmarrëse, vendimi zakonisht merret më heret. Këtu shpesh fjalën vendimtare e kanë personat e tjerë, e jo vetë kryerësi i veprave penale. Ai në shumë raste shfaqet si ekzekutues i vullnetit, i mendimit dhe i vendimit të huaj. Dihet se gjatë marrëveshjes për rrethanat e hakmarrjes, respektivisht të gjakmarrjes, fjalën kryesore e ka i zoti i shtëpisë, kështu që pa pëlqimin dhe pajtimin e tij përfundimtar, nuk mund të bëhet gjakmarrja ose ndonjë vepër penale. Duke pasur parasysh të gjitha këto, e me qëllim që të evitohen dhe mënjanohen këto dukuri, shfaqet si nevojë e domosdoshme ndjekja penale dhe dënimi më i rreptë e më konsekuent i personave, të cilët, në një mënyrë ose në një tjetër, i kontribuojnë kryerjes së këtyre veprave penale. Veçanërisht duhet ashpërsuar përgjegjësinë e të zotit të shtëpisë. Këto veprime të këtyre personave, në të shumtën e rasteve, mund të përfshihen me konceptim e nxitjes, respektivisht të ndihmës dhe ky nuk është ndonjë problem i madh. Mirëpo, problem është zbulimi dhe vërtetimi, respektivisht dëshmimi i një veprimtarie të këtillë të këtyre personave. Prandaj, mbetet që këtij problemi t'i kushtojmë një kujdes edhe më të madh.

Lidhur me atë që kemi thënë deri tash, duhet të shqyrtojmë edhe çështjen e mosparaqitjes dhe të përgatitjes së veprave penale, në pajtim me nenin 277, alinea 2 e LP, me kusht që kjo dispozitë t'i përfshijë edhe anëtarët e familjes, kur është fjala për veprën penale të vrasjes nga neni 135, aliena 1 e LP, sepse kështu do të veprohej në mënyrë preventive dhe represive për evitimin dhe mënjanimin e këtyre dukurive negative. Gjithashtu, për të penguar këto vepra penale, pra edhe për të ndikuar më shumë në paksimin e numrit të këtyre dukurive negative, do të ishte shumë e dobishme që për kërcënimin më serioz nga neni 153 i KP të bëhet ndjekja sipas detyrës zyrtare, e jo sipas propozimit, siç parashihej deri tash që edhe sanksionet për këtë vepër penale të zgjerohen, dmth. të parashihet maksimumi më i lartë i dënimit, pasi diapazoni më i gjerë i sanksioneve penale, do të mund t'i përshtatej rrezikut shoqëror, të cilin e paraqet kjo vepër, në një periudhë konkrete, respektivisht në një regjion të caktuar.⁹⁶

⁹⁶ Ramadan Vraniqi: *Krivično pravni aspekt krvne osvete na Kosovu*, Jugoslovenska revija za kriminologiju i krivično pravo, nr. 4, 1971 f.629—630, 631—632.

Duke qenë se pas aprovimit të amandamenteve të Kushtetutës së RSFJ, materja e një pjese të posaçme të LP për të cilën është fjala, duhet të kalojë në kompetencën e republikave socialiste dhe të krahinave autonome socialiste, poashtu ishte dashur të shqyrtohen mundësitë që disa çështje, të cilat kanë të bëjnë me këtë problematikë, të rregullohen në pajtim me nevojat dhe rrethanat specifike. Në këtë mënyrë, për shembull, me ligjin republikan ose krahinor, do të rregulloheshin çështjet që kanë të bëjnë me gjakmarrjen dhe me disa zakone të tjera negative që ndikojnë në shtimin e kriminalitetit. Kjo dispozitë, para së gjithash, do të duhet të bënte inkriminimin e veprës penale të vrasjes për shkak të gjakmarrjes, refuzimit të pajtimit etj. Kjo, para së gjithash, për arsye se në praktikën e deritashme ka pasur raste që, përkundër angazhimit të gjithanshëm të këshillit të pajtimit, gjyqit të pleqve dhe organizatave të tjera shoqërore-politike, s'kanë mundur të arrihen pajtimet, sepse familja e viktimës nuk është pajtuar në asnjë mënyrë me pajtimin vullnetar. Prandaj, ky pajtim do të duhej të bëhej i obligueshëm. Kjo mënyrë e rregullimit të kësaj çështje sot ekziston edhe në disa ligje penale të jashtme dhe, sipas mendimit të disa autorëve, ky inkriminim u tregua shumë efikas në evitimin e gjakmarrjes dhe të dukurive të tjera negative.⁹⁷

Mendojmë se, kur është fjala për rastet e rënda të vrasjes dhe të hakmarrjes, duhet të kemi më shumë guxim në shqiptimin e dënimit me vdekje, duhet t'i shmangemi politikës së zakonshme në këto vise, në mënyrë që ai të zëvendësohet me dënimin me burg të rëndë prej 20 vjetësh. Kjo për arsye se zbatimi i dënimit me vdekje dhe ekzekutimi i tij në këto vise edhe më tutje mund të ndikojë në mënyrë të dobishme në drejtim të preventivës së përgjithshme, sepse frika nga dënimi me vdekje në këto vise në shumë raste do t'i shtynte individët të heqin dorë nga kryerja e këtyre veprave të rënda penale. Në këtë mënyrë, ne do t'ia prisnim rrugën mundësisë për zbatimin e sanksioneve zakonore, kurse te qytetarët do të forconim besimin për efikasitetin e sanksioneve penale pozitive-juridike.

Aktiviteti dhe intervenimi me kohë i këshillave të pajtimit, është poashtu një formë shumë e përshtatshme dhe kompatible e mënjanimit të anëve negative të masave zakonore të reagimit. Dimë se pjesa dërmuese e mosmarrëveshjeve në këto vise lind për shkak të luajtjes së megjës, për shkak të së drejtës së përparësisë së ble-

⁹⁷ Kodi penal i RSSR (Republikës Sovjetik Socialiste të Rusisë nga viti 1960 me ndryshimet dhe plotësimet e vitit 1962) në kapitullin IX parasheh të ashtuquajturat vepra penale që janë mbeturit e zakoneve të tejkaluara lokale. Kështu psh. në nenin 231 të këtij Kodi, refuzimi për pajtim sanksionohet si vepër penale. Refuzimi i të afërmeve të të vrarit që të heqë dorë nga gjakmarrja kundër vrasësit dhe të afërmeve të tij, poqese propozimi për pajtim është bërë në procedurën e pajtimit për çështjen e gjakmarrjes, dënohet me dënim gjer në dy vjet ose me shpërngulje gjer në tri vjet. Një situatë të ngjashme kemi edhe me nenin 232, i cili sanksionon pagesën dhe marrjen e të hollave për martesë — grua. Në nenin 236 të këtij kapitulli flitet për kohën dhe vendin e aplikimit të këtij kapitulli („ky kapitull vlen për ato republika socialiste dhe krahina autonome të RSSR, ku veprat e rrezikshme shoqërore, të parapara në këtë kapitull, janë ruajtur si mbeturina të disa zakoneve të tejkaluara”).

rjes, për shkak të së drejtës së kalimit, të ujitjes, të dëmeve në fushë, për shkak të fejesës, konflikte këto që mund të zgjidhen shumëlehtë në mënyrë paqësore, me intervenimin me kohë dhe ndërmjetësinë e këshillave të pajtimit.⁹⁸ Me qëllim që këshillat e pajtimit të mund t'i sendërtojnë këto synime dhe të mund të afirmohen sa duhet në to duhet të zgjedhim qytetarët e shquar dhe punëtorët shoqëroro-politikë, të cilët i njohin mirë problemet dhe karakterin e banorëve të këtyre rretheve shoqërore. Për këtë arsye, ata duhet të përpiqen me mish e shpirt që të zgjidhin çdo rast konkret, duke u kushtuar kujdes të njëjtë edhe interesave të të dy palëve që janë në konflikt. Me fjalë të tjera, duhet të përpiqen në mënyrë maksimale që të mos jenë të njëanshëm me rastin e shqyrtimit dhe marrjes së vendimit për çdo rast konkret.

Rol të posaçëm në mënjanimin e këtyre rregullave të dëmshme zakonore, duhet të luajnë edhe punëtorët arsimorë të fshatit. Ata, përmes orëve të veçanta të edukimit shoqëror-moral, përmes organizimit të tubimeve të ndryshme, tribunave publike dhe me mënyra të tjera duhet t'u shpjegojnë banorëve të fshatit dhe nxënësve se sa të dëmshme dhe të prapambetura janë këto zakone. Ata duhet të jenë bartësit kryesorë të luftës për një mënyrë të re të trajtimit dhe të zgjidhjes së konflikteve reciproke, si dhe të marrëdhënieve të banorëve të fshatit. Punëtorët e arsimit, e jo vetëm ata, duhet të përpiqen veçanërisht të popullarizojnë zgjidhjen ligjore të konflikteve dhe të tregojnë dëmet e vetëgjyqimit dhe të reagimit privat. Në këtë drejtim, ata vetë duhet t'u shërbejnë si shembull të tjerëve, si pishtarë të marrëdhënieve të reja dhe përparimtare në fshat e jo, siç ndodh shpesh në këto vise, që disa të jenë bartës të dukurive negative.⁹⁹

Mjetet e informimit publik, shtypi, radioja, televizioni, duhet të ushtrojnë një ndikim më të madh mbi opinionin publik, për të zhvilluar ndjenjën dhe koshiencën për karakterin e dëmshëm të këtyre sanksioneve të prapambetura zakonore. Ata duhet të vejnë në dukje të gjitha anët negative të këtyre zakoneve dhe t'u kushtojnë një vend të posaçëm sanksioneve penale pozitive-juridike. Kjo nuk do të thotë se s'duhet të shkruajmë dhe të flasim për disa raste të zgjidhjes pozitive të konflikteve përmes sanksioneve zakonore. Për ato duhet të shkruajmë dhe të informojmë opinionin gjerësisht, por kjo çështje dhe kjo informatë nuk duhet t'i përkrahë ato mënyra të vjetra të zgjidhjes së konflikteve midis njerëzve në këto anë.

⁹⁸ R. Vranjqi — dr S. Pupovci: *Këshillat e pajtimit në Kosovë e Metohi*, Përpajtimi numër 5, 1968, f. 564—570—571 etj.

⁹⁹ Shpesh herë ndodh që disa punëtorë të arsimit, zakonisht mësuesit nëpër fshatra të bien nën ndikimin e rrethit dhe në këtë mënyrë në disa raste bëhen iniciatorë të konflikteve dhe vrasjeve për gjakmarrje. Kështu psh. një mësues nga rrethi i Prizrenit, aty nga fundi i vitit 1971, ka nxitë dhe organizuar vrasjen e dy personave të mitur — nxënësve, për shkak të hakmarrjes. Që e keqja të jetë më e madhe këta të mitur ishin nxënës po të asaj shkolle ku punonte ai si mësues.

Zbatimi eventual i disa masave nga këto

Në kushtet e ndikimit të mëtejshëm të së drejtës, zakonore në disa rrethe shoqërore është e domosdoshme të shqyrtohet mundësia e çrrënjësjes graduale të kësaj të drejte dhe të zëvendësimit të saj me të drejtën pozitive. Mirëpo, ky zëvendësim është i pamundur brenda një kohe të shkurtër. Themi kështu në rend të parë për arsye se e drejta zakonore i ka ende rrënjët shumë të thella dhe ajo do të qëndrojë një kohë të caktuar edhe në periudhën e ardhme. Duke u nisur nga ky fakt dhe nga disa faktorë të tjerë, në rend të parë nga konstatimi se sanksionet juridike-penale si dhe sistemi i dënimeve dhe mënyra e dënimit sot, në shumë raste nuk arrijnë të zgjidhin disa konflikte e as të ndikojnë në zvogëlimin e delikteve të gjakut në këto vise për shkak të pranisë së të drejtës zakonore dhe sanksioneve sipas kësaj të drejte, e cila e vështron këtë çështje ndryshe, shfaqet nevoja (që rrjedh nga kjo situatë konkrete) e hulumtimit të mundësisë së zbatimit të atyre sanksioneve të së drejtës zakonore, të cilat janë treguar të suksesshme në këtë drejtim dhe zbatimi i të cilave nuk do të ishte në kundërshtim me parimet e së drejtës sonë pozitive.

Masat e së drejtës zakonore, të cilat do të vinin në konsiderim që edhe sot të zbatohen në disa raste janë: bojkotimi — leçitja, shpërngulja, qortimi etj.

Leçitja zbatohet deri më sot dhe u tregua shumë efikase në rastet kur individët dhe familjet nuk u përmbaheshin marrëveshjeve të përbashkëta dhe rregullave të caktuara të sjelljes. Kështu, kjo masë do të mund të zbatohet edhe sot kundër atyre personave dhe familjeve që nuk duan të pajtohen, të cilët kërcënohen me hakmarrje, të cilët shkaktojnë konflikte dhe grindje të përhershme në fshat etj. Kjo praktikë zbatohet edhe sot në këto vise. Kështu, për shembull, viteve të fundit janë mbajtur disa tubime të përgjithshme burrash, pleqsh dhe aktivistësh, ku është vendosur njëzërit që të bojkotohen të gjitha ato familje e ata individë, të cilët hakmeren për vrasje ose fyerje të tjera dhe lëndime trupore.¹⁰⁰

Kjo masë ndikon si një formë preventive e represive për evitimin dhe mënjanimin e një pjese të zakoneve negative. Prandaj, në të ardhmen do të duhej që këtë masë ta zbatonte jo vetëm gjyqi i pleqve, por edhe disa organe e organizata të tjera shoqërore-politike të fshatit. Mendojmë që kjo masë duhet të përsoset edhe më dhe t'i jipet një karakter bashkëkohor. Ajo masë nuk duhet të jetë një sanksion i ri penal, por gjithsesi duhet të jetë një masë efikase shoqërore për mënjanimin e këtyre dukurive negative.

Mendojmë se edhe masa e qortimit duhet të zbatohet më shpesh, sepse edhe ajo është treguar si një masë preventive shumë efikase për evitimin e disa veprave penale, të cilat zakonisht e kanë bu-

¹⁰⁰ Janë të njohura tubimet e përgjithshme në Rugovë në nëntor të vitit 1970, në Korishë poashtu në nëntor të vitit 1970 si dhe tubimi i mbajtur më parë në Tuz, afër Titogradit, po në atë vit. Kjo formë e marrëveshjeve të përgjithshme popullore u tregue e dobishme, prandaj këtë duhet ta përkrahim me përpjekjet për zvogëlimin e krimeve për hakmarrje.

rimin në konfliktet dhe grindjet e vogla. Prandaj, kjo masë duhet të sanksionohet në një mënyrë të pranueshme. Atë duhet ta zbatojnë më tepër këshillat e pajtimit dhe organizatat e tjera të fshatit. Ajo duhet të zbatohet me kohë, të jetë e sigurtë dhe serioze, sepse vetëm poqese i plotëson këto kushte, mund të plotësojë qëllimin e vet, dmth. të ndikojë në mënyrë preventive mbi mënjanimin e delikteve të gjakut dhe të zakoneve të tjera të dëmshme.

Gjithashtu, mendojmë se në disa raste, përpos dënimit me marrjen e lirisë, duhet të parashihet edhe dënimi në të holla si masë e dorës së dytë. Kjo duhet të bëhet, sepse një masë e tillë do të goditte edhe pasurinë e kryerësit, gjë që do të ndikonte pozitivisht edhe mbi qytetarët e tjerë.

Dëbimi, gjegjësisht shpërngulja nga fshati, përkundër anëve negative, në disa raste mund të zbatohet edhe në kushtet e sotme. Kjo do të vinte në konsiderim atëherë kur konflikti i shkaktuar nuk mund të zgjidhet ndryshe, kurse nga ana tjetër, në çdo moment kanë rreziku nga një konflikt, sipas zakonisht edhe më i rëndë. Këtu është fjala kryesisht për familjet e po atij fshati që kanë rënë në gjak dhe ndërmjet së cilave ka pasur më shumë viktima dhe ku format e zakonshme të reagimit të organeve kompetente, nuk kanë qenë në gjendje të zgjidhin çështjen me të vërtetë, por vetëm formalisht. Prandaj, në këto rrethana, vetëm e vetëm shpërngulja nga ai vend, mund të ndikojë që të pengohet gjakderdhja e re dhe të bëhet pajtimi e zgjidhja e konfliktit përgjithmonë.

Këto janë disa prej masave të shumta të së drejtës zakonore, që i kemi ndarë si të mundshme për zgjidhjen e atyre konflikteve dhe grindjeve, të cilat në këto vise paraqesin më së shpeshti rrezikun permanent për shpërthimin dhe shfaqjen e gjakmarrjes. Këto masa do të përdreshin si preventivë që do evitonte e do të mënjantonte përsëritjen e disa sjelljeve që më vonë, nën ndikimin e së drejtës zakonore dhe të opinionit publik të rrethit shoqëror, shkaktojnë hakmarrjen dhe veprat e tjera të rënda penale. Kjo kursesë nuk duhet të kuptohet në këto raste si përjashtim i sanksioneve penale ligjore ose si zëvendësim i tyre, por këto masa, së bashku me sanksionet penale zakonore do t'i kontribuojnë zhdukjes së kriminalitetit në këto vise.

Nga kjo që thamë deri tash pasojat e sanksioneve penale sipas së drejtës zakonore, mund të përfundojmë se e drejta zakonore në përgjithësi dhe sanksionet penale sipas kësaj të drejte në veçanti janë të rëndësishme për rendin juridik vetëm poqese janë në pajtim me frymën e së drejtës pozitive dhe nëse i kontribuojnë forcimit të këtij rendi juridik. Mirëpo, në qoftë se e drejta zakonore dhe sanksionet juridike sipas kësaj të drejte janë në kundërshtim me të drejtën pozitive, atëherë ato paraqesin vështirësi për këtë rend.¹⁰¹ Për këtë arsye mendojmë se këto sanksione penale të së drejtës zakonore, të

¹⁰¹ Dr. S y r j a P u p o v c i: *Marrëdhënjet juridiko-civile në Kanunin e Lekë Dukagjinit*, Prishtinë, 1968. f. 289.

cilat nuk janë në kundërshtim me frymën e së drejtës sonë pozitive, duhet të zbatohen, kuptohet, vetëm poqese i kontribuojnë zhdukjes së zakoneve të përmendura negative dhe poqese shpien drejt zvogëlimit të numrit të vrasjeve për shkak të gjakmarrjes, respektivisht zhdukjes së plotë të gjakmarrjes në ato vende, ku ajo ekziston ende. Përkundrazi, sanksionet e së drejtës zakonore, të cilat janë në kundërshtim me frymën e së drejtës sonë pozitive dhe me rendin juridik, nuk duhet të tolerohen kurrsesi.

Ragip Halili

LES SANCTIONS PÉNALES SELON LE DROIT COUTUMIER DES ALBANAIS DU KOSOVO (II)

R é s u m é

Les délits avec effusion de sang dans la Province du Kosovo sont ces derniers temps en augmentation continuelle, en grande partie à cause de l'influence de l'ancien droit coutumier. C'est pourquoi on peut dire que parallèlement aux facteurs socio-économiques le droit coutumier joue aussi un rôle dans ces actions.

Les sanctions pénales sont des mesures sociales de réaction par lesquelles la société se protège de l'attitude dangereuse de certaines personnes. Elles se sont transformées à travers l'histoire de la société humaine. Au début elles étaient des mesures destinées à la protection sociale dans le cadre de la famille, des gens et de la tribu; mais plus tard elles sont devenues des mesures d'état par lesquelles une classe donnée de la société protège ses intérêts et empêche les attitudes criminelles dangereuses pour elle.

Au début les sanctions pénales étaient nombreuses et étaient dominées par des peines physiques très cruelles. Le but essentiel de ces peines était une certaine revanche envers les malfaiteurs. Plus tard, sous l'influence des idées philosophiques progressives et surtout sous l'influence des écoles, ces peines ont changé de caractère et sont devenues des moyens de prévention contre la criminalité et réadaptation des coupables. En ce qui concerne le développement des délits avec effusion de sang, on peut dire que les écoles de criminologie ont joué un rôle important.

Le droit coutumier représente un ensemble de règles juridiques fondées sur la confiance d'un groupe, d'une classe, d'une caste ou d'un groupe ethnique ou religieux. Ces règles sont établies grâce à une longue élaboration. Les caractéristiques de base du droit coutumier sont le conservatisme et le particularisme. Les règles du droit coutumier ne s'appliquent pas dans l'ensemble de la législation pénale contemporaine, ni dans notre législation pénale, bien entendu. Cependant, dans certains secteurs les règles coutumières s'appliquent, mais cette application est d'un caractère privé et souvent en contradiction avec les règles positives pénalo-juridiques.

Le droit coutumier albanais en général et les règles du *Code de Lekë Dukagjini* (Kanuni i Lekë Dukagjinit) en particulier, contiennent des dispositions sur les manières de punir. Ces sanctions pénales se distinguent des sanctions positives du droit pénal, comme elles se distinguent des sanctions pénales du droit coutumier des autres peuples.

Les sanctions pénales les plus importantes selon le droit coutumier sont : la peine de mort, la vendetta, le bannissement, le boycottage, l'amende l'extermination de la propriété et le blâme. Ces peines sont parmi les plus fréquentes dans le droit coutumier des Albanais. Cependant, parmi les autres

peuples de la région, d'autres peines ont existé (par exemple emprisonnement et peines physiques différentes), mais de nos jours, elles n'existent plus.

La caractéristique de ces sanctions est qu'elles ne sont pas aussi cruelles et barbares qu'elles ne l'étaient autrefois chez les autres peuples. Dans cette région des peines physiques comme la mutilation, l'amputation ou un autre genre de torture n'existent pas.

La peine de mort dans sa forme primitive, ne s'applique plus actuellement. Avant elle était prononcée par le tribunal des vieillards suite à de très graves infractions. Elle était acceptée par la masse, c'est à dire par le village entier ou par la tribu. Aujourd'hui la vendetta est considérée comme forme particulière de la peine de mort. Elle s'applique encore de nos jours dans cette région, et elle cause aujourd'hui de grands dommages. En ce qui concerne la place de la vendetta dans le système des sanctions pénales du droit coutumier, il existe différentes opinions. Actuellement, dans la province du Kosovo, on mène une lutte générale afin d'arrêter les crimes causés par la vendetta et pour anéantir cette coutume arriérée.

Le bannissement ou l'expatriation du village représente également une des peines importantes qui est appliquée par le droit coutumier du Kosovo. Aucune autre mesure ne peut faire un effet semblable sur les individus ou sur les familles que celle de l'expatriation. L'expatriation peut être provisoire ou à vie. Son but est en premier lieu une punition pour la famille ou la personne qui a commis un acte cruel. L'expatriation a eu et a toujours un caractère préventif. Selon certaines opinions, dans certains cas, cette mesure pourrait s'appliquer même aujourd'hui avec quelques modifications.

Le boycottage („leçitja") prend une place particulière dans le système des sanctions pénales du droit coutumier. Le boycote d'une personne ou d'une famille consiste en ce qu'une personne du village ou de la communauté ne voie plus la personne ou la famille, même pas à l'occasion d'une réjouissance ou d'une cause de tristesse. Le boycottage peut-être une mesure permanente ou provisoire. Cette mesure est en un sens semblable à l'expatriation, mais elle en diffère en ce sens que la personne ou la famille punie reste dans le village ou dans la communauté, alors que dans le cas de l'expatriation la personne ou la famille est obligée de quitter le village ou la communauté.

Le boycottage représente une mesure préventive très efficace pour l'arrêt des délits avec effusions de sang dans les régions où le vieux droit coutumier s'applique toujours. Par le boycottage on montre, d'une façon particulière à ceux qui ne respectent pas les règlements de la vie commune, les ennuis qu'ils peuvent en suivre. A cause de cela les individus font attention de ne pas enfreindre ces règlements.

Les peines concernant des biens (de la propriété) sont également appliquées dans le droit coutumier du Kosovo. Les plus importantes sont : la rançon, l'amende, la confiscation des biens ou l'anéantissement des biens.

La rançon provient de la vendetta, c'est à dire qu'elle apparaît en tant que compensation pour arrêter la vendetta. Le montant de cette compensation est fixée selon les coutumes locales et selon les règlements généraux du code de Lekë Dukagjini.

L'amende s'applique pour des délits ordinaires, comme le vol, les dommages des champs ou pour certaines formes d'offenses. Pour les questions de vol on applique le principe de „duex pour un" c'est à dire que l'amende doit être doublée par rapport à la valeur de l'objet volé. Dans la plupart des cas, cette peine se réalise volontairement de la part même du condamné. Auparavant si le condamné ne voulait pas payer l'amende, il y avait des gens appelés „gjobëtarë", qui dans le cadre de la communauté du village pouvaient selon les décisions du conseil des vieillards obliger la personne à payer l'amende. Cela se faisait habituellement en lui confisquant des animaux et différents objets.

La confiscation des biens, qu'elle soit partielle ou totale représente également une peine qui s'appliquait assez souvent. Cette peine s'appliquait avec la peine de mort ou la peine de l'expatriation. Selon l'opinion de certains auteurs, cette peine est semblable à la peine de la confiscation qui se fait encore de nos jours.

La confiscation des biens, surtout celle de la récolte, des terres avoisinant la maison ou la maison incendiée, le verger abattu, ont été également des peines souvent appliquées; mais plus de nos jours. Le droit coutumier au Kosovo n'applique plus la peine de prison, ni des peines physiques bien qu'elles aient été appliquées dans le passé dans certaines contrées de la région. On peut entendre dire dans le peuple que les peines physiques s'appliquaient uniquement aux femmes et aux enfants mineurs et parfois aux malades mentaux. On a également souvent appliqué certaines mesures sur la perte des droits civils et des droits d'honneurs. On connaît la perte du titre (fonction), la suppression du droit d'être élu dans une fonction ou dans un conseil de vieillards, la suppression du droit de présence dans les réunions de la communauté ou de la tribu. Ces mesures ont été également très efficaces.

Le blâme est une mesure particulière qui se distingue et qui s'applique dans des situations très particulières. En fait, le blâme consiste en une sincère et sérieuse réprobation envers celui qui a provoqué des troubles par son infraction. Cette réprobation est faite par les vieillards du village ou de la communauté. A cette occasion ils montrent au coupable les conséquences qui auraient pu se produire. Cette mesure s'est montrée très efficace pour empêcher à diverses occasions certains délits très graves. L'application ultérieure du droit coutumier au Kosovo cause plusieurs conséquences socialement dangereuses. On peut mieux remarquer ces conséquences dans le nombre des tués, des familles enfermées ou par la quantité de terres non-labourées, d'élèves et d'étudiants qui ne peuvent pas suivre leurs cours ou qui ont du interrompre tout à fait leurs études.

Pour ces raisons, il est nécessaire de prendre des mesures très efficaces pour faire disparaître les aspects négatifs de ces sanctions du droit coutumier. Dans le cadre de ces mesures il faut se consacrer particulièrement à l'amélioration de la situation, c'est à dire apprendre à lire et à écrire à la masse populaire des villages, embaucher et qualifier les agriculteurs et engager toutes les forces progressives de la campagne contre ces coutumes et la mentalité arriérée. Malgré les aspects négatifs de ces mesures il y a certains aspects positifs comme la suppression de certaines mauvaises conduites dans ces régions. C'est pourquoi nous pensons que certaines de ces mesures comme le boycottage, le blâme et certaines autres, doivent être appliquées dans certains cas particuliers, mais à condition qu'elles entraînent la suppression de la vendetta et de certains phénomènes qui sont présents au Kosovo parmi la population de la campagne. Le droit coutumier et les sanctions pénales selon ce droit sont d'une grande importance pour cet ordre juridique à condition qu'elles soient en accord avec l'esprit du droit positif et à condition que cela serve à renforcer cet état juridique. Cependant, si le droit coutumier se détache du droit positif, il peut créer des difficultés à cet ordre. C'est pourquoi nous pensons que les sanctions pénales du droit coutumier ne sont pas contradictoires à l'esprit de notre droit pénal; il faut bien entendu les appliquer à condition qu'elles contribuent à la disparition des coutumes mentionnées et qu'elles diminuent le nombre des victimes de la vendetta et de la criminalité en général dans ces milieux.

